

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
	TEMA I. PERIUDHA E DREJTIMIT DHE PUSHIMIT. RREGULLAT PËR KOHËN (ORËT) E DREJTIMIT TË MJETIT DHE PERIUDHAT E PUSHIMIT		
1	Të drejtosh kamionin për katër orë rresht, pa ndërprerje, përbën shkelje administrative.		Gabim
2	Pas një periudhe drejtimi prej katër orësh e gjysmë, drejtuesi i kamionit duhet të respektojë një periudhë pushimi të paktën 50 minuta rresht.		Gabim
3	Kohëzgjatja ditore e punës në drejtim të kamionit, lejohet të shtrihet deri në 10 orë, por jo më shumë se 2 herë në javë		Saktë
4	Kohëzgjatja e punës në drejtim të pandërprerë të kamionit, nuk mund të jetë më shumë se 4 orë e 30 minuta, përveç rasteve që mund të shkojë deri në 5 orë, kur nuk mund të gjendet sheshpushim		Saktë
5	Periudhat kohore të përdorura për pastrimin e kamionit konsiderohen "kohë të gatishmërisë"		Gabim
6	Ne rast se drejtuesi i kamionit ndërpret drejtimin për dyzet e pesë minuta pas katër orë e gjysmë drejtim e tij i nënshtrohet një sanksioni administrativ.		Gabim
7	Kohëzgjatja ditore e drejtimit të kamionit, për një drejtues, mund të jetë e ndarë në 2 periudha drejtimi të pandërprera, secila prej 4 orë e 30 minuta		Saktë
8	Periudhat e ndërprerjeve, të pushimeve dhe të gatishmërisë nuk përfshihen në llogaritjet e kohës së punës		Saktë
9	Kohëzgjatja ditore e drejtimit të kamionit, për një drejtues, nuk duhet t'i kalojë 9 orë, përveç rasteve që mund të jete deri në 10 orë, por jo më shumë se dy herë në javë		Saktë
10	Për një drejtues kamioni, koha maksimale e drejtimit ditor mund të jetë e ndarë në 2 periudha drejtimi të pandërprera, njëra prej të cilave është 6 orë		Gabim
11	Koha maksimale e drejtimit ditor, për një drejtues kamioni, nuk mund të jetë më shumë se 3 orë e 30 minuta pa ndërprerje		Gabim
12	Pushimi prej të paktën 45 minuta që duhet të bëjë drejtuesi i kamionit, pas periudhës së drejtimit të pandërprerë, mund të bëhet i ndarë në 3 periudha 15 minutëshe		Gabim
13	Gjatë drejtimit të kamionit është e lejueshme të përdorni një fletë regjistrimi të tahografit analog për më shumë se 24 orë.		Gabim
14	Periudhat kohore të shpenzuara për shërbimin ditor të kamionëve, konsiderohen "punë të tjera"		Saktë
15	"Kohë e gatishmërisë" konsiderohet koha në të cilën drejtuesi i mjetit duhet të jetë i gatshëm të rifillojë punën menjëherë, megjithëse jo domosdoshmërisht duhet të mbetet në vendin e punës.		Saktë
16	Periudhat kohore të përdorura për pastrimin e kamionit konsiderohen "kohë të gatishmërisë"		Gabim
17	"Kohë e gatishmërisë", nënkupton pëlqimin e punonjësit për të kryer detyra jashtë orarit normal të punës.		Gabim
18	"Ndërprerje", nënkupton çdo ndalesë të bërë me mjetin gjatë ditës së punës.		Gabim
19	"Ndërprerje", nënkupton çdo periudhë në të cilën drejtuesi i mjetit nuk drejton dhe nuk kryen detyra të tjera.		Saktë
20	Periudha ditore e drejtimit të kamionit është normalisht nëntë orë rresht.		Gabim
21	Kohët e përcaktuara si "punë të tjera" konsiderohen si kohë lëvizëse.		Gabim
22	Kohëzgjatja javore e drejtimit të mjetit, për një drejtues, nuk duhet ti kapërcejë 56 orë ndërmjet periudhave të pushimit javor ose 58 orë nëse kohëzgjatja e drejtimit 6 ditor shtrihet në dy javë		Saktë
23	Rregullorja për organizimin e kohës së punës të personave, e cila bazohet në Dispozitat e Rregullores së KE 561/2006, synon të rrisë nivelin e sigurisë rrugore		Saktë
24	"Kohët e gatishmërisë" janë ato gjatë të cilave drejtuesi mund të disponojë lirisht kohën e tij.		Gabim
25	Kohëzgjatja e përgjithshme e drejtimit të mjetit gjatë 2 javëve të njëpasnjëshme nuk duhet ti kapërcejë 90 orë		Saktë
26	Kohët e përcaktuara si "punë të tjera" tregohen nga simboli në figurë	951	Gabim
27	"Koha e gatishmërisë" tregohen nga simboli në figurë	951	Saktë
28	Kohët e përcaktuara si "punë të tjera" përfaqësohen në mënyrë konvencionale nga simboli në figurë.	950	Gabim
29	Koha e drejtimit të kamionit për një drejtues, nuk mund të jetë më shumë se 50 orë në një javë		Gabim
30	Periudha e ndërprerjeve të drejtimit të kamionit, është jo më pak se 45 minuta, kur mjeti është drejtuar për 4 orë e 30 minuta pa ndërprerje		Saktë
31	Kohëzgjatja e ndërprerjeve të drejtimit të kamionit, duhet të jetë jo më pak se 50 minuta, kur mjeti është drejtuar për 4 orë e 30 minuta pa ndërprerje		Gabim
32	Periudha e pushimit ditor e drejtuesit të kamionit, është periudha e pushimit të pandërprerë brenda kohës prej 24 orësh		Saktë

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
33	Periudha e pushimit ditor e drejtuesit të kamionit është jo më pak se 11 orë të vazhdueshme që mund të reduktohet minimumi në 9 orë, por jo më shumë se 3 herë në javë		Saktë
34	Periudha e pushimit ditore lejohet te reduktohet ne një minimum prej 9 ore, por jo me shume se 3 here ne jave		Saktë
35	Periudha e pushimit ditor e drejtuesit të kamionit, mund të bëhet e ndarë në dy pjesë nga 6 orë secila		Gabim
36	Periudha e pushimit ditor e drejtuesit të kamionit duhet të jetë 8 orë		Gabim
37	Drejtuesi i mjetit nuk përjashtohet nga përgjegjësia për shkeljet e rregullores se organizimit te kohës se punës ne transportin rrugor, kur mjeti është në pronësi të kompanisë		Saktë
38	Rregullorja për organizimin e kohës së punës të drejtuesve te mjeteve, ne transportin rrugor, synon të rrisë kohën e punës së drejtuesve te mjeteve		Gabim
39	Rregullorja për organizimin e kohës së punës të drejtuesve te mjeteve, ne transportin rrugor, parashikon që periudha e pushimit javor mund të jetë e llojit të rregullt ose të reduktuar		Saktë
40	Rregullorja për organizimin e kohës së punës të drejtuesve te mjeteve, ne transportin rrugor, zbatohet gjithashtu edhe për transportin hekurudhor		Gabim
41	Kompania e transportit mund të ulë pagën e drejtuesit, i cili refuzon të drejtojë mjetin për më shumë se 10 orë në ditë		Gabim
42	Kompania e transportit nuk është përgjegjëse për shkeljet e legjislacionit për drejtimin dhe kohën e pushimit të kryera, gjatë punës, nga drejtuesit e punësuar prej tyre kur janë jashtë vendit.		Gabim
43	Rregullorja për organizimin e kohës së punës të drejtuesve te mjeteve, ne transportin rrugor, zbatohet për transportin rrugor të mallrave, me automjete që kanë masë maksimale me ngarkesë mbi 3.5 tonë		Saktë
44	Prezenca e drejtuesit të dytë, kur ka dy drejtues në bord të automjetit për të gjithë periudhën, përveç tre orëve të para nuk është e detyrueshme		Gabim
45	Kur në mjet ndodhet më shumë se 1 drejtues, ndërkohë që njeri është duke drejtuar mjetin, drejtuesit e tjerë lejohet të marrin një periudhë të pushimit ditor.		Gabim
46	Rregullorja për organizimin e kohës së punës të drejtuesve te mjeteve, ne transportin rrugor, parashikon dispozita në lidhje me transportin e mallrave, por jo me transportin e udhëtareve		Gabim
47	Rregullorja për organizimin e kohës së punës të drejtuesve te mjeteve, ne transportin rrugor, parashikon që drejtuesi, në këmbim të një pagese shtese mund të heqë dorë nga periudha e pushimit javor		Gabim
48	Rregullorja për organizimin e kohës së punës të drejtuesve te mjeteve, ne transportin rrugor, parashikon dispozita në lidhje me kohën maksimale të lejuar ne drejtim të autobusëve në një javë		Saktë
49	Rregullorja për organizimin e kohës së punës të drejtuesve te mjeteve, ne transportin rrugor, parashikon dispozita për pagat minimale të drejtuesve të autobusëve		Gabim
TEMA II. PAJISJA REGJISTRUESE (TAHOGRAFI). PËRDORIMI I PAJISJEVE TË REGJISTRIMIT			
50	Drejtuesi i mjetit të pajisur me tahograf, para se të fillojë udhëtimin duhet të sigurohet që e ka futur kartën e tij në folenë e tahografit		Saktë
51	Drejtuesi i automjetit, që kryen transport ndërkombëtar të mallrave mund të pajiset me dy karta të ndryshme të tahografit		Gabim
52	Tahografi regjistron shpejtësinë e lëvizjes, kohën e drejtimit dhe kohën e ndërprerjes së drejtimit të automjetit		Saktë
53	Tahografi është detyrim që të vendoset tek të gjithë automjetit që kryejnë transport të mallrave		Gabim
54	Tahografi tregon edhe kohën e drejtimit të automjetit për çdo drejtues, kur mjeti drejtohet nga disa drejtues		Saktë
55	Tahografi përcakton dhe distancën e frenimit të automjetit		Gabim
56	Tahografi tregon edhe kohën e ndërprerjeve të drejtimit të automjetit nga drejtuesit e tij		Saktë
57	Tahografi tregon vetëm kohën e pushimit të drejtuesit të mjetit		Gabim
58	Tahografi tregon numrin e rrotullimeve të boshtit motorik		Gabim
59	Tahografi tregon vetëm kohën e ndërprerjeve të drejtimit të tij nga drejtuesit		Gabim
60	Automjetet për transportin ndërkombëtar të mallrave janë të pajisur me tahograf i cili duhet të jetë funksional		Saktë
61	Gjysmërimorkiatorët janë të pajisur me tahograf		Saktë
62	Autotrenat janë të pajisur me tahograf		Saktë
63	Tahografi vendoset në të gjitha automjetet		Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
64	Fletët e regjistrimeve të tahografëve analogë duhet të kenë një kapacitet minimal regjistrimi prej 24 orësh		Saktë
65	Fletët e regjistrimeve të tahografëve analogë duhet të jenë të një lloji të aprovuar		Saktë
66	Nga kujtesa e kartës së tahografit të drejtuesit është e mundur të gjurmohet aktiviteti i punës në 365 ditëve e mëparshme.		Gabim
67	Automjetet për transport malli me kapacitet nën 3.5 ton janë të pajisur me tahograf		Gabim
68	Autokarrot për transport malli janë të pajisura edhe me tahograf		Gabim
69	Tahografi vendoset vetëm në kamionët për transport ndërkombëtar mallrash		Gabim
70	Tahografi digjital përbëhet nga ekrani, tastiera, printeri dhe karta e tij		Saktë
71	Tahografi digjital ka dy vende për futjen e kartave të regjistrimit		Saktë
72	Tahografi digjital regjistron dhe ruan të dhënat sipas datave të qarkullimit me mjet		Saktë
73	Tahografi digjital regjistron edhe periudhën e pushimit të drejtuesit të mjetit		Saktë
74	Në tahografin digjital është e mundur të ruhen të dhëna në lidhje me aktivitetet e një ose dy drejtuesve të mjeteve		Saktë
75	Nga kujtesa e tahografit digjital është e mundur të printoni aktivitetet e ditës së punës së drejtuesit, ngjarjet dhe anomalitë, tejkalimet e shpejtësisë së lejuar dhe të dhënat teknike		Saktë
76	Drejtuesi i një gjysmërimorkiatori të pajisur me tahograf analog, para se të fillojë udhëtimin, duhet të shkruajë në fletën e regjistrimit që do të përdorë, datën e transportit të fundit të kryer jashtë vendit		Gabim
77	Drejtuesi i një kamioni të pajisur me tahograf analog, para se të fillojë udhëtimin, duhet të shkruajë datën e nisjes në fletën e regjistrimit që do të përdorë		Saktë
78	Drejtuesi i një gjysmërimorkiatori të pajisur me tahograf analog, para se të fillojë udhëtimin, duhet të shkruajë leximin e kilometrazhit në kohën e nisjes në fletën e regjistrimit që do të përdorë		Saktë
79	Para fillimit të udhëtimit, drejtuesi i një kamioni të pajisur me një tahograf analog duhet të shkruajë datën e tij të lindjes në fletën e regjistrimit që do të përdorë		Gabim
80	Drejtuesi i një gjysmërimorkiatori të pajisur me tahograf analog, para se të fillojë udhëtimin, duhet të shkruajë numrin dhe kategorinë e lejes së tij të drejtimit në fletën e regjistrimit që do të përdorë		Gabim
81	Tahografi digjital duhet të kalibrohet para se automjeti të vihet në qarkullim		Saktë
82	Tahografi digjital është i pajisur me një printer të integruar		Saktë
83	Tahografi digjital është një pajisje që ruan të dhëna në lidhje me 5 vitet e fundit		Gabim
84	Tahografi digjital është një pajisje që mund të regjistrojë vetëm aktivitetin e një drejtuesi të vetëm		Gabim
85	Tahografi digjital është një pajisje që regjistron aktivitetet e drejtuesit, por jo të dhëna që lidhen me automjetin		Gabim
86	Tahografi digjital lëshon një sinjal akustik që paralajmëron nëse automjeti po përdoret pa futur kartën e tahografit të drejtuesit		Saktë
87	Tahografi mund të jetë i tipit hidraulik		Gabim
88	Tahografi digjital ka vetëm një vend për futjen e kartës		Gabim
89	Tahografi digjital regjistron vetëm kohët e punës së drejtuesit të tij		Gabim
90	Tahografi digjital e merr lëvizjen nga boshti motorik		Gabim
91	Mjetet e përdorur për transportin e kafshëve të gjalla nga fermat të tregjet lokale dhe anasjelltas përjashtohen nga përdorimi i tahografit		Saktë
92	Përjashtohen nga përdorimi i tahografit automjetet që përdoren për instruksionin e drejtimit dhe provimit me synimin për të përfutur një leje drejtimi, me kusht që të mos përdoren për transport tregtar të mallrave dhe udhëtarëve, përjashtohen nga përdorimi i tahografit		Saktë
93	Drejtuesit e mjeteve të transportit të mallrave përjashtohen nga mbajtja e regjistrimeve, në ditët kur ata drejtojnë mjetin për 4 orë ose më pak, në një rreze deri 25 kilometra nga vendndodhja		Saktë
94	Mjetet e përdorur për transportime jo-tregtare të mallrave për përdorim personal, përjashtohen nga përdorimi i tahografit		Saktë
95	Automjetet vetëshkarkues përjashtohen nga përdorimi i tahografit		Gabim
96	Automjetet që përdoren për transport për të tretë ose me qira përjashtohen nga përdorimi i tahografit		Gabim
97	Drejtuesit e mjeteve për transport mallrash, të cilët nuk kërkojnë licencë për veprimtarinë në transportin rrugor të mallrave, përjashtohen nga mbajtja e regjistrimeve		Gabim
98	Cilido që qarkullon me një mjet që është i pajisur me tahograf, në rastin kur është parashikuar pajisja me të, ndëshkohet me gjobë dhe me masë administrative plotësuese të pezullimit të lejedrejtimit		Saktë

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
99	Përrjashtohen nga përdorimi i tahogرافit mjetet me shpejtësi maksimale te autorizuar deri ne 40 kilometra në orë		Saktë
100	Cilido që qarkullon me një mjet që është i pajisur me tahogراف, por ai nuk funksionon ose nuk plotëson kërkesat e caktuara me ligj, ndëshkohet me gjobë dhe me masë administrative plotësuese të pezullimit të lejedrejtimit		Saktë
101	Cilido që qarkullon me një mjet që është i pajisur me tahogراف, por nuk është futur karta e tahogرافit të drejtuesit, ndëshkohet me gjobë dhe me masë administrative plotësuese të pezullimit të lejedrejtimit		Saktë
102	Cilido që qarkullon me një mjet që ka të vendosur një tahogراف i cili është digjital, ndëshkohet me gjobë dhe me masë administrative plotësuese të pezullimit të lejedrejtimit		Gabim
103	Cilido që qarkullon me një mjet të pajisur me tahogراف ndëshkohet me gjobë dhe me masë administrative plotësuese të pezullimit të lejedrejtimit		Gabim
104	Nëse brenda 1 viti, konstatohen tri shkelje të përsëritura të qarkullimit të mjetit pa tahogراف, për mjete të parashikuar me tahogراف, përveç gjobës dhe pezullimit të lejedrejtimit (2 deri 3 muaj), merret edhe masë administrative plotësuese e pezullimit të lejes së transportit për 1 vit		Saktë
105	Për qarkullim me mjet të pa pajisur me tahogراف, në rastet kur është parashikuar pajisja me të, përveç gjobës dhe pezullimit të lejedrejtimit për drejtuesin, ndëshkohet me gjobë edhe mbajtësi i licencës ose i autorizimit të mjetit		Saktë
106	Në rast se pas 10 ditëve nga data e konstatimit të defektit të tahogرافit, mjeti vazhdon të qarkullojë me tahogراف jofunksional, bëhet ndalimi administrativ i mjetit		Saktë
107	Drejtuesi i mjetit para nisjes së ditës së punës duhet të vendosi kartën e tahogرافit në njësi		Saktë
108	Nëse humbet karta e drejtuesit të mjetit duhet të aplikohet për zëvendësim brenda 7 ditëve		Saktë
109	Nëse mjeti nuk është i pajisur me tahogراف, drejtuesi i mjetit është i përjashtuar gjithmonë nga mbajtja e regjistrimeve		Gabim
110	Nëse tahogرافي keqfunksionon, drejtuesi mund të vazhdojë udhëtimin duke shënuar me dorë aktivitetet e tij, pasi te ketë njoftuar kompaninë		Saktë
111	Nëse tahogرافي pëson defekt, drejtuesi i mjetit duhet të ndërpresë menjëherë udhëtimin deri në riparimin e tij		Gabim
112	Tejkalimi i shpejtësisë së lëvizjes për më pak se një minutë nuk do të regjistrohet si shkelje nga tahogرافي		Saktë
113	Tejkalimi i shpejtësisë së lëvizjes për më pak se pesë minuta nuk do të regjistrohet si shkelje nga tahogرافي		Gabim
114	Në ekranin e tahogرافit digjital, kohët "punë të tjera" tregohen nga simboli në figurën 950	950	Gabim
115	Në ekranin tahogرافin digjital, "kohët e gatishmërisë" tregohen nga simboli në figurën 952	952	Gabim
116	Në ekranin tahogرافin digjital, "kohët e gatishmërisë" tregohen nga simboli në figurën 953	953	Gabim
117	Në ekranin tahogرافin digjital, simboli në figurën 954, tregon funksionin "traget ose tren"	954	Saktë
118	Në ekranin tahogرافin digjital, simboli në figurën 954, tregon "aktivitetet e drejtimit"	954	Gabim
119	Ekzistojnë katër lloje të kartave të tahogرافit: karta e drejtuesit, karta e kompanisë, karta e oficinës dhe karta e zyrtarit të kontrollit		Saktë
120	Karta e tahogرافit të drejtuesit të mjetit ka një sfond të bardhë		Saktë
121	Karta e tahogرافit të kompanisë lëshohet nga Dhoma e Tregtisë		Gabim
122	Karta e tahogرافit të drejtuesit të mjetit mund të hiqet nga pajisja e regjistrimit vetëm kur mjeti është i palëvizshëm në parkun e kompanisë		Saktë
123	Karta e tahogرافit të kompanisë mund të përdoret nga drejtuesi i mjetit nëse e ka humbur kartën e tij		Gabim
124	Karta e tahogرافit të kontrolluesit përdoret nga drejtuesi i mjetit gjatë operacioneve të mirëmbajtjes së automjeteve		Gabim
125	Karta e tahogرافit të oficinës përdoret nga drejtuesi gjatë punimeve të riparimit në automjet		Gabim
126	Kartat e tahogرافit janë të vlefshme për pesë vjet, me përjashtim të kartës së oficinës		Saktë
127	Karta e tahogرافit të oficinës ka një vlefshmëri një vit		Saktë
128	Karta e tahogرافit të drejtuesit të mjetit ka një vlefshmëri tre vjet		Gabim
129	Karta e tahogرافit të drejtuesit të mjetit mund të memorizojë të dhëna, maksimumi për 20 ditë pune		Gabim
130	Karta e kontrollit përdoret kryesisht për të kontrolluar respektimin e kohës së drejtimit dhe shpejtësisë		Saktë

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
131	Karta e tahogرافit të drejtuesit të mjetit ka të njëjtat funksione si leja e drejtimit		Gabim
132	Karta e tahogرافit të drejtuesit të mjetit është në pronësi të kompanisë në të cilën ai është i punësuar		Gabim
133	Karta e tahogرافit të drejtuesit të mjetit lëshohet nga zyrat e punës		Gabim
134	Karta e tahogرافit të drejtuesit të mjetit pezullohet në rast të humbjes totale të pikëve të leje drejtimit.		Gabim
135	Në ekranin digjital të tahogرافit, simboli në figurë tregon "aktivitetet rekreative"	955	Gabim
136	Në ekranin e tahogرافit digjital, simboli në figurë, tregon funksionin "kontroll"	956	Saktë
137	Në ekranin digjital të tahogرافit, simboli në figurë, tregon funksionin "pushim javor"	956	Gabim
138	Në ekranin e tahogرافit digjital, simboli në figurë, tregon "madhësinë e gomës"	957	Gabim
139	Në takograf, funksioni "kohët e drejtimit" tregohet nga simboli në figurën 957	957	Saktë
140	Në ekranin e tahogرافit digjital, simboli në figurë, tregon mënyrën "Drejtimi i mjetit në zona private, jashtë kompetencës"	958	Gabim
141	Në ekranin e tahogرافit digjital, simboli në figurë, tregon "ndërprerjet e drejtimit"	958	Saktë
142	Në ekranin e tahogرافit digjital, kohët e drejtimit tregohen nga simboli në figurë	959	Gabim
143	Në ekranin e tahogرافit digjital, kohët e pushimit tregohen nga simboli në figurë	959	Saktë
144	Në ekranin e tahogرافit digjital, simboli në figurë, tregon funksionin "kompani"	960	Saktë
145	Në ekranin e tahogرافit digjital, simboli në figurë, tregon mënyrën e transportit "traget ose tren"	960	Gabim
TEMA III. LEGJISLACIONI PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE			
146	Me destinacion të mjetit kuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike		Saktë
147	Destinacioni i mjetit përcaktohet nga prodhuesi i tij nëpërmjet karakteristikave teknike		Saktë
148	Me destinacion të mjetit kuptohet vendi ku mjeti duhet të dorëzojë mallin që transporton		Gabim
149	Me destinacion të mjetit kuptohet vendi ku duhet të dërgohet ngarkesa		Gabim
150	Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik		Saktë
151	Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët		Saktë
152	Me përdorim të mjetit do të kuptojmë vetëm dhënien e tij me qira		Gabim
153	Transporti rrugor i mallrave përfshin edhe ngarkimin e mjetit		Saktë
154	Transporti rrugor i mallrave përfshin lëvizjen e mjetit me ngarkesë deri në destinacion		Saktë
155	Transporti rrugor i mallrave përfshin edhe shkarkimin e mallit në destinacion		Saktë
156	Transporti rrugor i mallrave përfshin edhe lëvizjen e mjetit pa ngarkesë deri në vendin e nisjes		Saktë
157	Transporti rrugor i mallrave nuk e përfshin lëvizjen e mjetit pa ngarkesë deri në vendin e nisjes		Gabim
158	Transporti rrugor i mallrave nuk e përfshin shkarkimin e mallit në destinacion		Gabim
159	Transporti rrugor i mallrave nuk e përfshin ngarkimin e mjetit		Gabim
160	Transporti ndërkombëtar i mallrave, i cili mund të jetë për llogari të vet, bën pjesë në transportin e mallrave		Saktë
161	Transporti i mallrave të rrezikshme bën pjesë në transportin e mallrave		Saktë
162	Në transportin e mallrave, përfshihet vetëm transporti ndërkombëtar i mallrave		Gabim
163	Transporti i mallrave për llogari të vet, brenda vendit, kryhet me certifikatë për ushtrim veprimtarie, përjashtuar transportin e disa lloje mallrash		Saktë
164	Transporti i mallrave për llogari të vet është transporti i mallrave me kamion vetëm për llogari të veprimtarisë së vetë subjektit		Saktë
165	Transporti i mallrave për llogari të vet është transporti i mallrave me kamion që shërben si veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore të subjektit		Saktë
166	Transporti i mallrave për llogari të vet, i kryer me mjete me kapacitet mbi 3.5 ton, bëhet vetëm kur automjeti i përdorur është pronë e sipërmarrësit të transportit		Gabim
167	Transporti i mallrave për llogari të vet nuk kryhet me certifikatë për ushtrim veprimtarie		Gabim
168	Transporti i mallrave për llogari të vet, i kryer me mjete me kapacitet mbi 3.5 ton, lejohet të kryhet në të gjitha rastet pa certifikatë		Gabim
169	Mallrat që transportohen brenda vendit pa pasur nevojë që mjeti të pajiset me certifikate transporti, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin		Gabim
170	Transporti Ndërkombëtar i mallrave mund të jetë për llogari të vet		Saktë
171	Transporti ndërkombëtar i mallrave ndërmjet shteteve anëtare të ECMT/CEMT (Anëtarë të Forumit të Transportit Ndërkombëtar) bëhet me leje bilaterale		Saktë
172	Transporti Ndërkombëtar i mallrave për nevojat e veta kryhet me licencë të lëshuar nga Ministri		Gabim
173	Transporti Ndërkombëtar i mallrave për llogari të vet, kryhet pa certifikatë		Gabim
174	Transporti Ndërkombëtar i mallrave është vetëm për të tretë dhe me qira		Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
175	Transporti i mallrave për llogari të vet quhet transporti i mallrave me kamion në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vetë subjektivit		Saktë
176	Veprimtaria e transportit të mallrave për nevojat e veta, brenda vendit, kryhet mbi bazën e certifikatës		Saktë
177	Transporti i mallrave për nevojat e veta brenda vendit, përveç disa rasteve, është i ndaluar të kryhet pa certifikate		Saktë
178	Kamionët për transport mallrash për të tretë dhe me qira, me kapacitet transportues nën 1500 kg, përjashtohen nga detyrimi i pajisjes me certifikatë transporti		Saktë
179	Transporti ndërkombëtar i mallrave për nevojat e veta kryhet me certifikatë ose leje bilaterale		Saktë
180	Transporti i mallrave për të tretë dhe me qira që bëhet me mjete të pastrimit të borës dhe shpërndarjes së kripës në rruge, nuk certifikohet		Saktë
181	Transporti i mallrave për të tretë dhe me qira që bëhet me mjete që transportojnë mallra të rastit në aeroporte, nuk certifikohet		Saktë
182	Transporti i mallrave për nevoja të veta, brenda vendit, për furnizimin e farmacive ose spitaleve me barna mjekësore, bëhet pa certifikatë transporti		Saktë
183	Transporti i mallrave për nevoja të veta, brenda vendit, i sendeve dhe lëndëve të forcave të armatosura, bëhet pa certifikatë transporti		Saktë
184	Në transportin e mallrave, përfshihet vetëm transporti ndërkombëtar i mallrave		Gabim
185	Transporti i mallrave për llogari të vet kryhet vetëm me licencë		Gabim
186	Transporti i mallrave për llogari të vet, i kryer me mjete me kapacitet mbi 3.5 ton, lejohet të kryhet në të gjitha rastet pa certifikatë transporti		Gabim
187	Certifikata e transportit nuk është e detyrueshme për transportin e mallrave për llogari të vet		Gabim
188	Kamionët me kapacitet transportues nën 1500 kg, janë të detyruar të pajisen me certifikatë transporti, por jo me licencë		Gabim
189	Furnizimi i njësive tregtare me vezë, peshk, perime, qumësht, etj., brenda qytetit, përfshihet në llojet e mallrave që transportohen për llogari të vet brenda vendit dhe që nuk kanë nevojë për certifikatë		Saktë
190	Transporti i prodhimeve bujqësore për në fabrika përfshihet në llojet e mallrave që transportohen për llogari të vet brenda vendit dhe që nuk kanë nevojë për certifikatë transporti		Saktë
191	Transporti i orendive e pajisjeve shtëpiake përfshihet në llojet e mallrave që transportohen për llogari të vet brenda vendit dhe që nuk kanë nevojë për certifikatë transporti		Saktë
192	Çimento e paketuar me thasë përfshihet në llojet e mallrave që transportohen për llogari të vet brenda vendit dhe që nuk kanë nevojë për certifikatë transporti		Gabim
193	Furnizimi i njësive tregtare me peshk nga jashtë qytetit përfshihet në llojet e mallrave që transportohen për llogari të vet brenda vendit dhe që nuk kanë nevojë për certifikatë transporti		Gabim
194	Furnizimi i farmacive dhe spitaleve me barna edhe jashtë qytetit përfshihet në llojet e mallrave që transportohen për llogari të vet brenda vendit dhe që nuk kanë nevojë për certifikatë transporti		Gabim
195	Furnizimi i njësive tregtare me fruta e perime nga jashtë vendit përfshihet në llojet e mallrave që transportohen për llogari të vet brenda vendit dhe që nuk kanë nevojë për certifikatë transporti		Gabim
196	Automjetet për përdorim të veçantë, janë mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të veçantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave		Saktë
197	Një automjet për transportin e ujërave të zeza, hynë në grupin e automjeteve për transport të veçantë		Saktë
198	Të gjitha automjetet e rënda për punime ndërtimi e toke konsiderohen automjete për përdorim të veçantë		Gabim
199	Një autocisternë, edhe nëse ka pajisje të përshtatshme për ngarkimin dhe transportin e ujërave të zeza, nuk mund të klasifikohet si automjet për përdorim të veçantë		Gabim
200	Autocisternat, autofrigoriferët, borë pastrueset, etj., hynë në grupin e automjeteve për përdorim të veçantë		Gabim
201	Mjetet motorike të përdorura për transportin e mallrave, me masë maksimale me ngarkesë më shumë se 3,5 tonë, duhet të jenë të pajisura me dy panele të pasme reflektuese të tipit të miratuar me vija diagonale të verdha dhe të kuqe, si në figurë	304	Saktë
202	Mjetet motorike të përdorura për transportin e mallrave, me masë maksimale me ngarkesë më shumë se 3,5 tonë, duhet të pajisen me katër panele të pasme reflektuese të tipit të miratuar me vija diagonale të verdha dhe të kuqe si në figurë	304	Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
203	Automjetet e përdorur për transportin e mallrave, me një masë maksimale me ngarkesë më shumë se 3,5 tonë, duhet të jenë të pajisur me dy panele reflektuese (sipas tipit të miratuar) të vendosur në pjesën e pasme, si në figurë	304	Saktë
204	Automjetet e përdorur për transportin e mallrave, me masë maksimale me ngarkesë më shumë se 3,5 tonë, duhet të pajisen me dy panele trekëndore reflektuese të verdha, të vendosur në pjesën e pasme	304	Gabim
205	Mjetet motorike të përdorura për transportin e mallrave për llogari të vet, me masë maksimale me ngarkesë mbi 6 tonë, duhet të kenë një shirit të bardhë të pjerrët përpara dhe pas mjetit		Gabim
206	Mjetet e përdorura për transportin e mallrave për llogari të palëve të treta, me masë maksimale me ngarkesë mbi 6 tonë, duhet të kenë një shirit të kuq të pjerrët përpara dhe pas mjetit.		Gabim
207	Shpejtësia maksimale e lejuar për makineritë e rënda të ndërtimit duhet të jetë 100 km/orë		Gabim
208	Mjetet teknologjike vetëlëvizëse duhet të kenë shpejtësi maksimale 40 km/orë		Saktë
209	Mjetet teknologjike duhet të jenë të pajisura me të paktën 5 akse		Gabim
210	Mjetet teknologjike duhet të jenë të përshtatshme për përdorim specifik në kantiere ashtu edhe në rrugë		Saktë
211	Mjetet e punës duhet të përdoren ekskluzivisht brenda kantierëve të ndërtimit		Gabim
212	Rimorkiot, që përdoren për transportin e mallrave, me një masë maksimale me ngarkesë më shumë se 3,5 tonë duhet të jenë të pajisura me panel prapa reflektues sipas tipit të miratuar, si në figurë	305	Saktë
213	Rimorkiot dhe gjysmërimorkiot, që përdoren për transportin e mallrave me një masë totale të ngarkuar më shumë se 3,5 tonë, duhet të jenë të pajisura me dy panele të pasme reflektuese të miratuara, me ngjyrë të verdhë dhe kontur të kuq, si në figurë.	305	Saktë
214	Rimorkiot dhe gjysmërimorkiot që përdoren për transportin e mallrave, me masë maksimale me ngarkesë më shumë se 3,5 tonë, duhet të pajisen me katër panele të pasme reflektuese në ngjyrë të verdhë me kontur të kuq.		Gabim
215	Automjetet e përdorura për transportin e mallrave, me masë maksimale me ngarkesë më shumë se 3,5 tonë, duhet të jenë të pajisur me shirita reflektues prapa dhe anash (sipas tipit të miratuar), me ngjyrë të verdhë, nëse kanë karroceri të mbyllur dhe të kuqe nëse janë të mbuluara me tendë		Gabim
216	Automjetet e përdorur për transportin e mallrave, me masë maksimale me ngarkesë më shumë se 3,5 tonë, duhet të jenë të pajisur me shirita reflektues jeshilë		Gabim
217	Automjetet e përdorur për transportin e mallrave, me masë maksimale me ngarkesë më shumë se 3,5 tonë, duhet të pajisen me shirita reflektues që vendosen në pjesën e pasme dhe anësore me ngjyrë blu		Gabim
218	Panelet reflektues (sipas tipit të miratuar) me ngjyrë të bardhë ose të verdhë, vendosen vetëm për mjetet që kalojnë 18.75 metra		Gabim
219	Automjetet e përdorur për transportin e mallrave, me masë maksimale me ngarkesë më shumë se 3,5 tonë, nuk ka nevojë të pajisen prapa me panele reflektues, si në figurë, nëse qarkullojnë kryesisht gjatë ditës.		Gabim
220	Automjetet që transportojnë mallra të rrezikshëm duhet të pajisen me dy panele reflektuese ngjyrë portokalli, të fiksuara përpara dhe pas automjetit (si në figurë).	303	Saktë
221	Automjetet që transportojnë mallra të rrezikshëm, nëse transportojnë më shumë se një lëndë të rrezikshme në ndarje të veçanta, duhet të kenë panelet përkatëse reflektuese në ngjyrë portokalli në pjesën anësore, ku secili panel tregon lëndën që transportohet	303	Saktë
222	Automjetet që transportojnë mallra të rrezikshëm, nëse mbajnë më shumë se një lëndë të rrezikshme në ndarje të veçanta të rezervuarit, duhet të kenë disa panele reflektuese në ngjyrë portokalli në anën e pasme, ku secila tregon lëndën e transportuar	303	Gabim
223	Autocisternat, me masë maksimale me ngarkesë më shumë se 3,5 tonë, duhet të pajisen në pjesën e pasme dhe anësore me shirita reflektues në ngjyrë blu.		Gabim
224	Automjetet jashtë normë, që tejkalojnë kufijtë maksimalë të gjerësisë duhet të pajisen me dy panele katrore me sfond të verdhë, të fiksuara në të dy pjesët anësore të mjetit dhe me shkrimin në ngjyrë të zezë "Transport në kushte jonormale"		Gabim
225	Automjetet jashtë normë, që tejkalojnë kufirin maksimal të gjerësisë, duhet të pajisen me dy panele reflektuese me vija bardh e zi, të vendosur në pjesën e përparme dhe të pasme të mjetit.		Gabim
226	Automjetet jashtë normë, që tejkalojnë kufijtë maksimal në gjatësi duhet të pajisen me katër drita të kuqe shitesë		Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
227	Numri mbi vijën horizontale, i treguar në sinjalin në figurë, tregon "shkallën" e rrezikut që lidhet me mallrat e rrezikshëm që transportohen	303	Saktë
228	Numri nën vijën horizontale, i treguar në sinjalin në figurë, tregon llojin e mallrave të rrezikshëm të transportuar	303	Saktë
229	Sinjali i treguar në figurë përdoret për të sinjalizuar ngarkesat që dalin jashtë automjetit, nga pjesa e pasme	302	Saktë
230	Sinjali i treguar në figurë duhet të vendoset, në çdo rast, kur ngarkesa del nga pjesa e pasme e automjetit	302	Saktë
231	Sinjali i treguar në figurë duhet të jetë i fiksuar para dhe pas mjeteve të cilët transportojnë mallra të kategorisë ushqimore dhe tregon përkatësisht "kodin e produktit" dhe masën e transportuar (në kilogramë)	303	Gabim
232	Sinjali i treguar në figurë duhet të jetë i fiksuar përpara dhe pas mjetit që transporton një mall të rrezikshëm specifik sipas ADR	303	Saktë
233	Sinjali i treguar në figurë duhet të jetë reflektues	303	Saktë
234	Sinjali i treguar në figurë është vendosur pas kamionëve të artikuluar për të sinjalizuar ngarkesat , që dalin jashtë automjetit	279	Gabim
235	Sinjali i treguar në figurë mund të zëvendësohet me një flamur të kuq, me përmasa 50x50 centimetra	279	Gabim
236	Sinjali i treguar në figurë duhet të vendoset në automjete vetëm nëse ngarkesa del jashtë mjetit, të paktën 50 centimetra	279	Gabim
237	Sinjali i treguar në figurë përdoret për të sinjalizuar ngarkesat, që dalin nga pjesa e pasme, në anën e djathtë të automjetit	279	Gabim
238	Sinjali i treguar në figurë vendoset në pjesën e pasme të kamionëve, me një masë maksimale me ngarkesë mbi 33 tonë	303	Gabim
239	Sinjali i treguar në figurë vendoset në pjesën e pasme të autobetoniereve	303	Gabim
240	Sinjali i treguar në figurë vendoset në mjetet e përdorura për transportin ATP (transporti i mallrave delikat, në temperatura të kontrolluara)	303	Gabim
241	Sinjali i treguar në figurë vendoset në mjetet e përdorura për transportin e barnave mjekësore	303	Gabim
242	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e kamionëve të artikuluar	303	Gabim
243	Sinjali i treguar në figurë vendoset në pjesën e pasme të automjeteve, që kanë një gjatësi të barabartë ose më të madhe se 7 metra	303	Gabim
244	Sinjali i treguar në figurë tregon ngarkesa të pandashme, që dalin nga pjesa e pasme e automjetit	302	Saktë
245	Sinjali i treguar në figurë duhet të vendoset në fund të ngarkesës që del pas mjetit	302	Saktë
246	Sinjali i treguar në figurë duhet të vendoset në fund të ngarkesës që del nga automjeti, në mënyrë që të jetë gjithmonë i dukshëm	302	Saktë
247	Nëse ngarkesa del jashtë automjetit në gjatësi (në të gjithë gjerësinë e pjesës së pasme të mjetit), në dy skajet e ngarkesës duhet të vendosen 2 panele si në figurë	302	Saktë
248	Dalja gjatësore e ngarkesës, deri në 3/10 e gjatësisë së mjetit, duhet të sinjalizohet me anë të një ose dy paneleve katërkëndëshe si në figurë.	302	Saktë
249	Sinjali i treguar në figurë vendoset vetëm në kamionët për transportimin e materialeve të ndërtimit	302	Gabim
250	Sinjali i treguar në figurë njofton drejtuesit e mjeteve të tjerë, që lëvizin pas mjetit mbi të cilin është vendosur sinjali, të qarkullojnë me kujdes të veçantë	302	Saktë
251	Sinjali i treguar në figurë përdoret vetëm nëse ngarkesa del më shumë se 3/10 e gjatësisë së mjetit	302	Gabim
252	Sinjali i treguar në figurë mund të vendoset në automjete me defekt, kur ata tërhiqen dhe dritat e rrezikut nuk funksionojnë	302	Saktë
253	Paneli plotësues në figurë mund të kombinohet me një sinjal ndalimi	127	Saktë
254	Paneli plotësues në figurë mund të kombinohet me një sinjal detyrimi	127	Saktë
255	Paneli plotësues në figurë tregon kategorinë e automjetit, për të cilin zbatohet ndalimi ose detyrimi	127	Gabim
256	Sinjali i treguar në figurë duhet të vendoset pas të gjithë kamionëve me një masë maksimale me ngarkesë, që kalon 3,5 tonë	57	Gabim
257	Sinjali i treguar në figurë vendos një kufi për numrin maksimal të automjeteve, që mund të kalojnë në një vepër arti	57	Gabim
258	Sinjali i treguar në figurë tregon se mund të parkojnë të gjitha automjetet, përveç gjymërimorkiatorëve	923	Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
259	Sinjali i treguar në figurë ndalon kalimin vetëm për gjysmërimorkiatorët	921	Saktë
260	Sinjali i treguar në figurë lejon kalimin e gjysmërimorkiatorëve	921	Gabim
261	Sinjali i treguar në figurë ndalon pushimin e gjysmërimorkiatorëve	921	Saktë
262	Sinjali i treguar në figurë lejon qarkullimin e gjysmërimorkiatorëve	920	Gabim
263	Sinjali i treguar në figurë, i shoqëruar me një panel plotësues, ku shënohet 5 tonë, ndalon parakalimin e kamionëve me masë maksimale me ngarkesë mbi 5 tonë, ndaj mjeteve të tjera motorike	60	Saktë
264	Sinjali i treguar në figurë lejon mjetet për përdorim të veçantë, me masë maksimale me ngarkesë që tejkalon 3,5 tonë, të parakalojnë mjetet e tjera motorike	60	Gabim
265	Sinjali i treguar në figurë kur shoqërohet edhe me një panel plotësues, që tregon 5 tonë, ndalon automjetet për transport mallrash, me masë maksimale me ngarkesë mbi 5 tonë, të parakalojnë mjetet motorike	60	Saktë
266	Sinjali në figurë, i integruar me një panel plotësues, që tregon 5 tonë, ndalon qarkullimin e automjeteve për transport mallrash me masë maksimale me ngarkesë mbi 5 tonë	60	Gabim
267	Sinjali i treguar ndalon parakalimin e mjeteve të tjera motorike nga automjetet me masë maksimale me ngarkesë mbi 3.5 tonë, të cilat nuk janë të destinuara për transportin e udhëtarëve	60	Saktë
268	Sinjali në figurë nuk i lejon drejtuesit e automjeteve për përdorim të veçantë, me masë maksimale me ngarkesë që tejkalon 3.5 tonë, të parakalojnë mjetet pa motor edhe nëse manovra mund të kryhet brenda korsisë së lëvizjes	60	Gabim
269	Në mungesë të ndalimeve të tjera, sinjali i treguar lejon automjetet me masë maksimale me ngarkesë deri në 3,5 ton, të parakalojnë mjetet motorike	60	Saktë
270	Në prani të sinjalit të shfaqur, të integruar me një panel plotësues që tregon 5 tonë (në mungesë të ndalimeve të tjera), drejtuesit e mjeteve me një masë totale me ngarkesë të plotë mbi 5 tonë mund të parakalojnë mjete të tjera motorike, që lëvizin ngadalë	60	Gabim
271	Sinjali në figurë mund të pajiset me një panel plotësues, ku shënohet një vlerë për masën maksimale të automjeteve, mbi të cilën nuk lejohet parakalimi nga këta mjete	60	Saktë
272	Sinjali i treguar mund të vendoset në pjesë të rrugës, ku parakalimi është i vështirë	60	Saktë
273	Sinjali i treguar në figurë vendoset pranë një kantieri rrugor	284	Saktë
274	Sinjali i treguar detyron të gjithë automjetet të vazhdojnë drejt	284	Gabim
275	Sinjali i shfaqur paralajmëron një për një devijim të rekomanduar të drejtimit, për kamionët dhe autotrenat	284	Gabim
276	Sinjali i paraqitur vendoset në rrugë për periudhën kur kryhen punime në rrugë	284	Saktë
277	Sinjali i treguar në figurë këshillon të gjitha automjetet të ndjekin drejtimin e treguar nga shigjeta	284	Gabim
278	Sinjali në figurë paralajmëron për devijim të këshillueshëm të drejtimit që duhet të ndjekin autotrenat, për të mos kaluar në qendrën e banuar	250	Saktë
279	Sinjali në figurë këshillon automjetet, që paraqiten në panel, mund të ndjekin drejtimin e treguar	250	Saktë
280	Sinjali në figurë nuk është sinjal detyrimi	250	Saktë
281	Sinjali i shfaqur paralajmëron për një devijim të rekomanduar të drejtimit, për kamionët dhe autotrenat	250	Saktë
282	Sinjali i treguar në figurë ndalon kthimin në të djathtë për të gjithë kamionët	250	Gabim
283	Sinjali i treguar në figurë u tregon kamionëve drejtimin për në qendrën e qytetit	250	Gabim
284	Sinjali i treguar detyron automjetet e paraqitura në tabelë të kthehen menjëherë djathtas	250	Gabim
285	Sinjali i treguar duhet të respektohet edhe nga drejtuesit e autotrenave	79	Saktë
286	Sinjali i treguar në figurë i referohet masës së ngarkesës mbi aks në momentin e kalimit në këtë segment rruge	79	Saktë
287	Sinjali i treguar vlen vetëm për automjetet me dopiogomë	79	Gabim
288	Sinjali i treguar ndalon kalimin e të gjithë automjeteve me masë maksimale me ngarkesë më shumë se 2.5 tonë	79	Gabim
289	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e kamionëve me masë maksimale me ngarkesë, me vlerë më të madhe se ajo e treguar në figurë	79	Gabim
290	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet qarkullimi i kamionëve me masë efektive për aks deri 2,5 tonë	79	Saktë
291	Sinjali i treguar në figurë ndalon qarkullimin e mjeteve, që kanë një masë efektive, në aksin më të ngarkuar, më të madhe ajo e treguar	79	Saktë
292	Sinjali i treguar në figurë ndalon qarkullimin e automjeteve, që kanë masë maksimale për aks më të madhe se 6.5 tonë	79	Saktë

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
293	Sinjali i treguar në figurë duhet të respektohet vetëm nga drejtuesit e mjeteve, që përdoren për transportin e mallrave	77	Gabim
294	Sinjali i treguar në figurë është i vlefshëm edhe gjatë natës	77	Saktë
295	Sinjali i treguar detyron një automjet të mbajë një distancë, të paktën 10 metra , nga mjeti që vjen pas	77	Gabim
296	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e automjeteve me gjatësi më të madhe se ajo që tregohet në tabelë	77	Saktë
297	Sinjali në figurë tregon se mund të qarkullojnë të gjitha automjetet , përveç atyre të kategorive të paraqitura në figurë	151	Saktë
298	Në prani të sinjalit të treguar, ndalohet qarkullimi i kategorive të mjeteve që paraqiten në figurë	151	Saktë
299	Në prani të sinjalit të treguar, ndalohet qarkullimi i gjysërrimorkatorëve, nëse në lejen e qarkullimit të mjetit masa maksimale me ngarkesë është më e madhe se 6.5 tonë	151	Saktë
300	Sinjali në figurë tregon një itinerar të detyrueshëm për automjetet e kategorive të paraqitura në figurë	151	Gabim
301	Sinjali në figurë tregon një vend parkimi për kamionë dhe autotrena	151	Gabim
302	Sinjali në figurë ndalon lëvizjen drejt, për kamionët me masë maksimale mbi 3,5 tonë	169	Saktë
303	Sinjali i treguar në figurë përmban një ndalim drejtimi, që vlen për një kategori të caktuar automjetesh	169	Saktë
304	Sinjali në figurë tregon ndalimin për të vazhduar lëvizjen në drejtim të qendrës së qytetit, për kamionët me një masë maksimale me ngarkesë më shumë se 3.5 tonë	169	Saktë
305	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e kamionëve me masë maksimale me ngarkesë, më të madhe se ajo e treguar	169	Gabim
306	Sinjali i treguar ndalon të gjitha automjetet të lëvizin drejt qendrës së qytetit, gjatë orëve me trafik të rënduar	169	Gabim
307	Sinjali në figurë tregon drejtimin e rekomanduar (drejt) për kamionët me masë me ngarkesë maksimale që tejkalojnë 3,5 tonë	169	Gabim
308	Sinjali në figurë tregon ndalimin e qarkullimit për mjetet e transportit të mallrave me masë maksimale me ngarkesë më shumë se 3.5 tonë	72	Gabim
309	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e kamionëve me tendë	72	Gabim
310	Sinjali në figurë këshillon që kamionët të kthehen djathtas	150	Gabim
311	Sinjali i treguar ndalon kthimin djathtas, për automjetet e paraqitura në figurë	150	Gabim
312	Sinjali i treguar ndalon kamionët, me masë maksimale me ngarkesë mbi 3,5 tonë, të vazhdojnë lëvizjen drejt	150	Saktë
313	Sinjali në figurë tregon një zonë parkimi, të rezervuar për kamionë me një peshë maksimale me ngarkesë që tejkalojnë 3.5 tonë	150	Gabim
314	Sinjali në figurë tregon një kthesë djathtas të rrezikshme për kalimin e kamionëve	150	Gabim
315	Sinjali i paraqitur paralajmëron një ndalim të kthimit majtas, për kamionët me masë maksimale me ngarkesë mbi 3.5 tonë	150	Saktë
316	Sinjali i paraqitur paralajmëron një kthesë të detyrueshme djathtas, për kamionët me një masë maksimale me ngarkesë mbi 3.5 tonë	150	Saktë
317	Sinjali i treguar paralajmëron një kthesë të detyrueshme për automjetet e paraqitura në tabelë	150	Saktë
318	Sinjali i treguar në figurë vlen edhe për kamionët që transportojnë mallra ushqimore	78	Saktë
319	Sinjali i treguar në figurë ndalon kalimin transit të mjeteve që kanë një masë efektive më të madhe se ajo e treguar	78	Saktë
320	Sinjali i treguar në figurë duhet të vendoset në automjetet që transportojnë mbetjet urbane	78	Gabim
321	Sinjali i treguar në figurë, i integruar me një panel plotësues, mund të ndalojë qarkullimin e njëkohshëm të disa automjeteve	78	Saktë
322	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e të gjitha automjeteve me masë maksimale me ngarkesë më shumë se 7 tonë, pavarësisht nga masa e tyre në momentin e kalimit në këtë pjesë rruge	78	Gabim
323	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e automjeteve me pajisje frigoriferike	72	Gabim
324	Sinjali i treguar në figurë ndalon qarkullimin e autocisternave, që transportojnë benzinë	72	Saktë
325	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet qarkullimi i automjeteve që transportojnë produkte lehtësisht të ndezshëm, kur ato nuk janë shpërthyes	72	Gabim
326	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e automjeteve që transportojnë mallra ushqimore delikate që prishen	72	Gabim
327	Sinjali i treguar në figurë ndalon qarkullimin e automjeteve që transportojnë mallra të rrezikshëm	72	Saktë

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
328	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet tërheqja e automjeteve që transportojnë produkte lehtësisht të ndezshme	73	Gabim
329	Sinjali i treguar në figurë ndalon qarkullimin e automjeteve që transportojnë produkte lehtësisht të ndezshëm	73	Saktë
330	Sinjali në figurë paralajmëron të tregohet vëmendje në qarkullim, pasi kalojnë automjete që transportojnë lëndë plasëse	73	Gabim
331	Sinjali i treguar në figurë ndalon qarkullimin e automjeteve që transportojnë lëndë plasëse	73	Saktë
332	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e automjeteve që transportojnë substanca që mund të ndotin ujin	74	Saktë
333	Sinjali në figurë tregon një segment rruge, që i nënshtrohet përmbytjeve	74	Gabim
334	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet qarkullimi i autocisternave që transportojnë ujë	74	Saktë
335	Sinjali në figurë tregon që lejohet parakalimi i autoveturave nga automjetet e transportit të mallrave, me masë maksimale me ngarkesë që tejkalon 3,5 tonë	74	Gabim
336	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e autocisternave bosh	74	Gabim
337	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet qarkullimi i kamionëve me një masë maksimale me ngarkesë më pak se 3,5 tonë	68	Saktë
338	Në prani të sinjalit të treguar lejohet qarkullimi i të gjithë kamionëve me karroceri të hapur	68	Gabim
339	Sinjali i treguar ndalon kalimin e të gjithë kamionëve me rimorkio me karroceri të mbyllur	68	Gabim
340	Sinjali i treguar në figurë është një detyrim për autoveturat dhe jo për autobusët ose automjetet me masë maksimale me ngarkesë mbi 3.5 tonë	68	Gabim
341	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e mjeteve të përdorura për transportin e mallrave me masë maksimale me ngarkesë, që tejkalon 3,5 tonë	68	Saktë
342	Në prani të sinjalit të treguar, lejohen të qarkullojnë kamionë me masë prej 7,5 tonësh, kur ata janë plotësisht të shkarkuar (bosh)	69	Gabim
343	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet qarkullimi i automjeteve për përdorim të veçantë, me masë maksimale me ngarkesë më të madhe se 6,5 tonë	69	Gabim
344	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet qarkullimi i kamionëve me masë maksimale me ngarkesë 5 tonë	69	Saktë
345	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet qarkullimi i një kamioni që tërheq një rimorkio	70	Gabim
346	Sinjali i treguar vlen vetëm për automjetet që përdoren për transportin e mallrave	70	Gabim
347	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e mjeteve motorike që tërheqin një rimorkio	70	Saktë
348	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet qarkullimi i një automjeti të artikuluar, nëse ai qarkullon pa ngarkesë	70	Gabim
349	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet qarkullimi i një automjeti që tërheq një karel	70	Saktë
350	Në prani të sinjalit të treguar, është e nevojshme të zvogëlohet shpejtësia, në mënyrë që të mos rrezikohet zhvendosja e ngarkesës së mallrave të transportuara, duke rrezikuar stabilitetin e automjetit	4	Saktë
351	Në prani të sinjalit të treguar, është e nevojshme të ulni shpejtësinë, veçanërisht nëse jeni duke drejtuar një autocisterne të ngarkuar	4	Saktë
352	Në prani të sinjalit të treguar, është e nevojshme të zvogëlohet shpejtësia, në mënyrë që të mos rrezikohet zhvendosja e ngarkesës së mallrave të transportuara, gjë që mund të sjellë destabilitetin e automjetit	6	Saktë
353	Në prani të shenjës së treguar, është e nevojshme të ulni shpejtësinë, veçanërisht nëse jeni duke drejtuar një autocisternë të ngarkuar	6	Saktë
354	Në prani të sinjalit të treguar është e nevojshme të moderoni shpejtësinë, veçanërisht nëse jeni duke drejtuar një autocisternë të ngarkuar, për më tepër nëse rruga ka pjerrësi të madhe.	6	Saktë
355	Në prani të sinjalit të treguar, drejtuesi i një mjeti të rëndë duhet të jetë shumë i kujdesshëm për t'u siguruar që mjetet, që vijnë nga drejtimi i kundërt, të jenë të gatshëm t'i japin përparësi në qarkullim	53	Saktë
356	Në prani të sinjalit të treguar duhet të rrisni shpejtësinë, për të liruuar sa më shpejt segmentin e ngushtë të rrugës me një sens lëvizje	53	Gabim
357	Nëse sinjali i treguar është i pranishëm, duhet të ngadalësoni shpejtësinë duke përdorur vazhdimisht frenat, për të shmangur dëmtimin e kutisë së ndërrimit të shpejtësisë	17	Gabim
358	Nëse shfaqet sinjali i treguar në figurë, duhet të shmangjet përdorimi i zgjatur i frenave, në mënyrë që ato të mos mbinxehen	17	Saktë

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
359	Në prani të sinjalit të treguar, nëse jeni duke drejtuar një autocisterne të ngarkuar, duhet të zvogëloni shpejtësinë dhe të kryeni zbritjen me shumë kujdes	17	Saktë
360	Në prani të sinjalit të treguar, nëse jeni duke drejtuar një autocisterne bosh dhe pjerrësia e rrugës është e madhe, para se të filloni zbritjen këshillohet të mbushni rezervuarin deri në gjysmë të volumit me ujë, për të stabilizuar automjetin	17	Gabim
361	Ngadalësuesi i shpejtësisë duhet të vihet në punë, nëse shfaqet sinjali në figurë	17	Saktë
1387	Frenimi automatik i rimorkios (frenimi i sigurisë) funksionon në përputhje me shtypjen e pedalit të frenit në tërheqës		Gabim
1388	Frenimi automatik i rimorkios (frenimi i sigurisë) komandohet nga drejtuesi i mjetit gjatë lëvizjes		Gabim
1389	Frenimi automatik i rimorkios (frenimi i sigurisë) nuk vepron kur drejtuesi i mjetit e shkëput rimorkion nga tërheqësi		Gabim
1390	Frenat e shërbimit të rimorkios funksionojnë në përputhje me shtypjen e pedalit të frenit në tërheqës		Saktë
1391	Frenat e shërbimit të rimorkios realizojnë fillimin e frenimit të rimorkios njëkohësisht ose më përpara se të tërheqësit		Saktë
1392	Frenat e shërbimit të rimorkios realizojnë një forcë frenimi në rrotë që përputhet me korsën e pedalit të frenave të tërheqësit		Saktë
1393	Frenat e shërbimit të rimorkios realizon ndalimin e rimorkios pa veprimin e drejtuesit të mjetit		Gabim
1394	Frenat e shërbimit të rimorkios nuk shërbejnë gjatë lëvizjes normale të mjetit		Gabim
1395	Frenat e shërbimit të rimorkios veprojnë nëse rimorkio shkëputet nga kamioni aksidentalisht		Gabim
1396	Frenat e qëndrimit (parkimit) të rimorkios dhe gjysmërimorkios mund të jenë mekanike ose me ajër (pneumatike)		Saktë
1397	Frenat e qëndrimit (parkimit) të rimorkios dhe gjysmërimorkios kur janë me ajër (pneumatike) aktivizohen me anë të valvolës të frenave të qëndrimit që ndodhen në kabinën e tërheqësit		Saktë
1398	Frenat e qëndrimit (parkimit) të rimorkios dhe gjysmërimorkios komandohen nga drejtuesi i mjetit te valvola e frenave të qëndrimit (parkimit)		Saktë
1399	Frenat e qëndrimit (parkimit) të rimorkios dhe gjysmërimorkios përdoren edhe gjatë lëvizjes në raste emergjente		Gabim
1400	Frenat e qëndrimit (parkimit) të rimorkios dhe gjysmërimorkios komandohen nga drejtuesi i mjetit te valvola e frenave të shërbimit		Gabim
1401	Frenat e qëndrimit (parkimit) të rimorkios dhe gjysmërimorkios veprojnë nëse rimorkio shkëputet nga kamioni aksidentalisht		Gabim
1402	Dritat e pozicionit të vendosur prapa janë pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimeve të rimorkios		Saktë
1403	Sinjalet e drejtimit të vendosur prapa janë pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimeve të rimorkios		Saktë
1404	Sinjalet reflektues me ngjyrë të kuqe që vendosen prapa janë pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimeve të rimorkios		Saktë
1405	Sinjalet reflektues me ngjyrë të bardhë që vendosen para janë pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimeve të rimorkios		Saktë
1406	Panelet reflektuese të vendosur prapa rimorkios, janë pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimit kur pesha e përgjithshme e rimorkios është mbi 3.5 ton		Saktë
1407	Dritat e sinjaleve të frenave janë pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimeve të rimorkios		Saktë
1408	Pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimeve të rimorkios janë vetëm dy sinjalet reflektuese		Gabim
1409	Pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimeve të rimorkios janë edhe dy fenerë kundër mjegullës të vendosur në pjesën e përparme		Gabim
1410	Pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimeve të rimorkios janë dy panelet reflektuese të vendosur në pjesën e përparme		Gabim
	TEMA XI. NDËRTIMI DHE FUNKSIONIMI I MOTORËVE ME DJEGIE TË BRENDSHME, LËNGJET (P.SH., VAJI I MOTORIT, LËNGU FTOHËS), SISTEMI I USHQIMIT, SISTEMI ELEKTRIK, SISTEMI I NDEZJES, SISTEMET E TRANSMETIMIT TË LËVIZJES (FRIKSIONI, KUTIA E SHPEJTËSISË ETJ.)		
1411	Mekanizmat e transmetimit të lëvizjes mundësojnë transmetimin e lëvizjes nga motori tek rrotat aktive të automjetit		Saktë
1412	Mekanizmat e transmetimit të lëvizjes përbëhen nga friksioni, kutia e shpejtësisë, transmisioni, diferenciali, etj.		Saktë
1413	Mekanizmat e transmetimit të lëvizjes realizojnë edhe zvogëlimin e ngarkesave përdredhëse dinamike që transmetohen në motor		Saktë

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
1414	Mekanizmat e transmetimit të lëvizjes shërbejnë vetëm për transmetimin e lëvizjes nga kutia e shpejtësisë, te rrotat aktive		Gabim
1415	Sistemi satelitor GPS është pjesë e sistemit të transmetimit të lëvizjes		Gabim
1416	Në shumë kamionë, transmetimi hidraulik zëvendëson friksionin dhe kutinë e ndërrimit të shpejtësisë manuale		Saktë
1417	Elementët e sistemit të transmetimit të lëvizjes përdoren për ta mbajtur kompaninë të informuar për pozicionin e automjetit		Gabim
1418	Elementët e sistemit të transmetimit të lëvizjes nuk gjenden në automjetet elektrike		Gabim
1419	Semiakset (gjysmëakset) nuk bëjnë pjesë në sistemin e transmetimit të lëvizjes së automjetit		Gabim
1420	Mekanizmat e transmetimit të lëvizjes janë pjesë të motorit		Gabim
1421	Balestra, volani dhe kufizuesi i shpejtësisë janë pjesë e sistemit të transmetimit të lëvizjes		Gabim
1422	Friksioni, kutia e shpejtësisë dhe diferenciali janë pjesë e sistemit të transmetimit të lëvizjes		Saktë
1423	Friksioni është pjesë e mekanizmave të sistemit të transmetimit të lëvizjes		Saktë
1424	Kutia e shpejtësisë (kambio) është pjesë e mekanizmave të sistemit të transmetimit të lëvizjes		Saktë
1425	Transmisioni kardanak është pjesë e mekanizmave të sistemit të transmetimit të lëvizjes		Saktë
1426	Diferenciali dhe gjysmëakset (semiakset) janë pjesë e mekanizmave të sistemit të transmetimit të lëvizjes		Saktë
1427	Boshti motorik është pjesë e mekanizmave të sistemit të transmetimit të lëvizjes		Gabim
1428	Stabilizatorët me balestrat e mjeti janë pjesë e mekanizmave përbërës të sistemit të transmetimit të lëvizjes		Gabim
1429	Friksioni realizon transmetimin dhe shkëputjen e lëvizjes nga boshti motorik në boshtin primar të kutisë së shpejtësisë		Saktë
1430	Friksioni mund të jetë mekanik ose hidraulik		Saktë
1431	Disa automjete janë të pajisura me një friksion me shumë disqe		Saktë
1432	Friksioni bën të mundur nisjen e qetë të mjetit nga vendi		Saktë
1433	Friksioni mbron motorin dhe mekanizmat e tjerë të lëvizjes nga mbingarkesat dinamike		Saktë
1434	Friksioni është mirë të shtypet shpesh për të zvogëluar distancën e sigurisë me mjetin para		Gabim
1435	Friksioni është pjesë e motorit		Gabim
1436	Friksioni transmeton lëvizjen nga kutia e shpejtësisë në diferencial		Gabim
1437	Friksioni mekanik ndihmon drejtuesin e mjetit për të realizuar ndërrimin e marsheve		Saktë
1438	Friksioni mekanik mund të ketë sistem komandimi të tipit mekanik, hidraulik apo me ajër (pneumatik)		Saktë
1439	Friksioni mekanik shërben edhe për zbutjen e ngarkesave dinamike që lindin gjatë lëvizjes së mjetit		Saktë
1440	Friksioni mekanik realizon transmetimin e lëvizjes nëpërmjet vajit		Gabim
1441	Friksioni mekanik përbëhet vetëm nga disku i friksionit me ferrota		Gabim
1442	Friksioni mekanik merr lëvizjen nga kutia e shpejtësisë (kambio)		Gabim
1443	Friksioni mekanik realizon ndezjen e motorit		Gabim
1444	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik ndërpret transmetimin e lëvizjes nga boshti i motorit për në rrotat aktive të mjetit		Saktë
1445	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik shkakton ndarjen e diskut (apo disqeve) me ferrota nga volani i motorit		Saktë
1446	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik realizohet nga drejtuesi i mjetit me këmbën e majtë		Saktë
1447	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik e mbajtur për një kohë të gjatë dëmton kushinetën e friksionit		Saktë
1448	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik siguron ndërrimin e lehtë të marsheve		Saktë
1449	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik realizon transmetimin e fuqisë motorike në rrotat drejtuese të mjetit		Gabim
1450	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik gjatë lëvizjes së mjetit sjell ndaljen e menjëhershme të tij		Gabim
1451	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik shkakton bashkimin e disqeve të friksionit		Gabim
1452	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik shërben për transmetimin e lëvizjes		Gabim
1453	Friksioni mekanik mund të jetë me një ose disa disqe		Saktë
1454	Friksioni mekanik ka në përbërje të tij diskut (apo disqet) me ferrota dhe diskut shtrëngues (spinxhidiskun)		Saktë
1455	Friksioni mekanik përdoret dhe në mjetet e rënda		Saktë
1456	Friksioni mekanik është pjesë e motorit		Gabim
1457	Friksioni mekanik përbëhet nga disku i friksionit, i cili e merr lëvizjen nga kutia e shpejtësisë		Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
1458	Friksioni mekanik punon në ambient vaji		Gabim
1459	Friksioni hidraulik është pjesë e mekanizmave të transmetimit të lëvizjes		Saktë
1460	Friksioni hidraulik transmeton xhirot e boshtit motorik në boshtin e parë të kutisë së shpejtësisë (kambios)		Saktë
1461	Friksioni hidraulik përbëhet nga pjesa aktive (pompa) dhe ajo pasive (turbina)		Saktë
1462	Friksioni hidraulik punon me vaj hidraulik i cili duhet të ndërrohet periodikisht		Saktë
1463	Friksioni hidraulik është pjesë e motorit		Gabim
1464	Friksioni hidraulik punon me vajin e motorit		Gabim
1465	Friksioni hidraulik nuk është pjesë e mekanizmave të transmetimit të fuqisë		Gabim
1466	Friksioni me shumë disqe është i përshtatshëm veçanërisht për automjetet me masë dhe / ose fuqi të madhe		Saktë
1467	Friksioni me shumë disqe nuk vendoset asnjëherë në automjete të rënda		Gabim
1468	Friksioni me shumë disqe mund të jetë i thatë ose i lagur me ujë		Gabim
1469	Friksioni me shumë disqe mund të jetë i thatë ose i lagur me vaj		Saktë
1470	Friksioni me shumë disqe mund të vendoset vetëm në automjete me kuti ndërrimi të shpejtësisë automatike		Gabim
1471	Friksioni me shumë disqe mund të jetë vetëm i thatë		Gabim
1472	Friksioni me shumë disqe përdoret nëse kutia e shpejtësisë ka më shumë se 4 raporte shpejtësie (marshe)		Gabim
1473	Friksioni lejon të ndryshoni marshet kur automjeti është në lëvizje		Saktë
1474	Friksioni lejon të lidhni dhe shkëputni motorin me përbërësit e tjerë të sistemit të transmetimit		Saktë
1475	Friksioni lejon të lidhni dhe shkëputni gradualisht motorin me rrotat e aktive		Saktë
1476	Friksioni lejon të lidhni dhe shkëputni gradualisht motorin me pompën e injektimit		Gabim
1477	Friksioni lejon të lëvizni automjetin duke bashkuar gradualisht boshtin motorik me rrotat aktive përmes elementëve të sistemit të transmetimit		Saktë
1478	Friksioni mban motorin në punë kur automjeti është i palëvizshëm me një marsh të ingranuar		Saktë
1479	Friksioni është komponenti kryesor i sistemit të transmetimit automatik		Gabim
1480	Friksioni është vendosur midis kutisë së shpejtësisë dhe boshtit kardanic		Gabim
1481	Friksioni ftohet nga një ventilator special		Gabim
1482	Friksioni është një pajisje që lejon boshtin motorik të rrotullohet pa transmetuar lëvizje në elementët e sistemit të transmetimit		Saktë
1483	Friksioni është një pajisje që ju lejon të ndryshoni raportin midis numrit të rrotullimeve të boshtit motorik dhe numrit të rrotullimeve të boshtit kardanic të transmetimit		Gabim
1484	Friksioni është një mekanizëm që funksionon me anë të fërkimit		Saktë
1485	Friksioni është pjesë e përbërësve të sistemit të shuarjes së lëkundjeve (amortizimit)		Gabim
1486	Friksioni nuk ka nevojë për mirëmbajtje pasi është vetë-rregullues		Gabim
1487	Disku i friksionit është i lidhur direkt me boshtin ndihmës të kutisë së shpejtësisë		Gabim
1488	Disku i friksionit është i lidhur direkt me boshtin hyrës (primar) të kutisë së shpejtësisë		Saktë
1489	Disku i friksionit është i lidhur direkt me boshtin e transmetimit (sekondar) të kutisë së shpejtësisë		Gabim
1490	Disku i friksionit është prej çeliku dhe nuk ka asnjë shtresë		Gabim
1491	Disku i friksionit nuk duhet të ketë kurrë kontakt me volanin		Gabim
1492	Disku i friksionit, kur friksioni është i stakuar (pedali i ngritur), është në kontakt me volanin		Saktë
1493	Ferrota (material kundër fërkimi) e vendosur tek disku i friksionit duhet të lubrifikohet dhe grasatohet periodikisht		Gabim
1494	Ferrota (material kundër fërkimi) e vendosur tek disku i friksionit duhet të pastrohet periodikisht me benzinë		Gabim
1495	Ferrota (material kundër fërkimi) e vendosur tek disku i friksionit i nënshtrohet konsumimit		Saktë
1496	Ferrota (material kundër fërkimi) e vendosur tek disku i friksionit nuk i nënshtrohet konsumimit		Gabim
1497	Ferrota (material kundër fërkimi) e vendosur tek disku i friksionit kur konsumohet shkakton rrëshqitjen e diskut në volan		Saktë
1498	Pedali i friksionit kontrollon satelitët e diferencialit		Gabim
1499	Pedali i friksionit komandon kushinetën e friksionit		Saktë
1500	Pedali i friksionit duhet të lëshohet gradualisht		Gabim
1501	Pedali i friksionit mund të komandojë kushinetën me anë të pajisjeve hidraulike		Saktë
1502	Pedali i friksionit mund të komandojë kushinetën me anë të pajisjeve mekanike		Saktë
1503	Pedali i friksionit mund të komandojë kushinetën me anë të pajisjeve pneumatike		Saktë

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
1504	Pedali i friksionit mund të lëshohet papritmas nga shoferi kur niseni		Gabim
1505	Gjatë drejtimit të mjetit, në mënyrë që të shpejtoni ndërrimin e marsheve, duhet ta mbështesni këmbën gjithmonë mbi pedalin e friksionit		Gabim
1506	Komandimi hidraulik i friksionit zvogëlon forcën e ushtruar mbi pedale nga drejtuesit		Saktë
1507	Komandimi hidraulik i friksionit përmirëson qëndrueshmërinë e automjetit gjatë kthesës		Gabim
1508	Komandimi hidraulik i friksionit përdor presionin e ajrit për të zvogëluar forcën ushtruar mbi pedale të drejtuesit		Gabim
1509	Komandimi hidraulik i friksionit përdor presionin e vajit të motorit për të zvogëluar forcën ushtruar mbi pedale të drejtuesit		Gabim
1510	Komandimi hidraulik i friksionit përdor presionin e vajit për të zvogëluar forcën ushtruar nga drejtuesi mbi pedale		Saktë
1511	Gjatë muajve të dimrit ekziston rreziku që friksioni të bllokohet për shkak të formimit të akullit brenda tij		Gabim
1512	Kur automjeti është në lëvizje, friksioni shpëputet nga volani		Gabim
1513	Në të gjitha automjetet ka një pedale friksioni		Gabim
1514	Në tatëpjetë (zbritje) është mirë të udhëtoni me pedalin e friksionit të shtypur për të kursyer karburant		Gabim
1515	Mbingarkesa e automjetit rrit konsumin e friksionit		Saktë
1516	Në përgjithësi, automjetet e rënda janë me rrota aktive të përparme		Gabim
1517	Kutia e shpejtësisë përmban vaj lubrifikues i cili duhet të zëvendësohet periodikisht		Saktë
1518	Kutia e shpejtësisë përmban vaj lubrifikues, niveli i të cilit duhet të kontrollohet periodikisht		Saktë
1519	Kutia e shpejtësisë (kambio) shërben për të ndryshuar shpejtësinë e lëvizjes së mjetit, sipas kushteve rrugore e të qarkullimit dhe për lëvizje të mjetit prapa		Saktë
1520	Kutia e shpejtësisë me ingranazhe (kambio manuale) me levën e marsheve në pozicion neutral (afoljo), kur motori është i ndezur, shpëput xhirot për në transmision		Saktë
1521	Kutia e shpejtësisë me ingranazhe (kambio manuale) merr lëvizjen nga friksioni dhe ja jep transmisionit kardanik		Saktë
1522	Kutia e shpejtësisë me ingranazhe (kambio manuale) transmeton lëvizjen në friksion		Gabim
1523	Kutia e shpejtësisë me ingranazhe (kambio manuale) shërben vetëm për të ndryshuar shpejtësinë e lëvizjes		Gabim
1524	Në marshin e parë, numri i rrotullimeve që dalin nga kutia e shpejtësisë është më i ulët se numri i rrotullimeve të boshtit motorik		Saktë
1525	Në marshin e parë, numri i rrotullimeve që dalin nga kutia e shpejtësisë është më i lartë se numri i rrotullimeve të boshtit motorik		Gabim
1526	Kutia e shpejtësisë përmban vaj lubrifikues në të cilin ingranazhet janë zhytur pjesërisht		Saktë
1527	Kutia e shpejtësisë e automjeteve elektrike në përgjithësi ka më shumë raporte shpejtësie sesa ajo e vendosur në automjetet me motorë me djegie të brendshme		Gabim
1528	Kutia e shpejtësisë vendoset midis boshtit me gunga dhe friksionit		Gabim
1529	Kutia e shpejtësisë është një mekanizëm që lejon që rrotat të rrotullohen më shpejt se boshti motorik		Gabim
1530	Kutia e shpejtësisë nuk ka kurrë dy marshe me të njëjtin numër xhiros rpm		Saktë
1531	Kutia e shpejtësisë nuk ka kurrë më shumë se 6 marshe		Gabim
1532	Kutia e shpejtësisë lejon që një forcë e ndryshueshme të transmetohet në rrota në varësi të marshit të ingranuar		Saktë
1533	Kutia e shpejtësisë shërben për të mbajtur konstante shpejtësinë e rrotullimit të boshtit të kardanik, pavarësisht nga numri i rrotullimeve të motorit		Gabim
1534	Kutia e shpejtësisë përdoret për të ndryshuar raportin midis rrotullimeve të motorit dhe rrotullimeve të boshtit të transmetimit dhe rrjedhimisht, të rrotave lëvizëse		Saktë
1535	Këmba e majtë e drejtuesit, kur ai nuk vepron për të ndryshuar marshin, nuk duhet të mbështetet në pedalin e friksionit		Saktë
1536	Sinkronizuesi është një pajisje që është pjesë e kutisë së shpejtësisë dhe që lejon që boshti me gunga dhe boshti i transmetimit të rrotullohen me të njëjtën shpejtësi		Gabim
1537	Sinkronizuesi është një pajisje që lehtëson bashkimin e ingranazheve të kutisë së shpejtësisë kur ndryshoni nga një marsh në tjetrin		Saktë
1538	Sinkronizuesi e bën më të lehtë dhe më të qetë bashkimin e ingranazheve të kutisë së shpejtësisë		Saktë
1539	Ndonjëherë ngadalësuesi i shpejtësisë mund të vendoset në dalje të kutisë së shpejtësisë		Saktë

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
1540	Kalimi në një marsh ingranimi më të lartë rrit shpejtësinë e motorit		Gabim
1541	Kutia e shpejtësisë automatike (kambio automatike) përbëhet nga mekanizma që realizojnë ndryshim të pa shkallëzuar të momentit përdredhës		Saktë
1542	Kutia e shpejtësisë automatike (kambio automatike) ka boshtin primar që është i lidhur me turbinën e friksionit hidraulik		Saktë
1543	Kutia e shpejtësisë automatike (kambio automatike) realizon nisje të qetë të mjetit nga vendi		Saktë
1544	Kutia e shpejtësisë automatike (kambio automatike) nuk ka nevojë për vajosje		Gabim
1545	Kutia e shpejtësisë automatike (kambio automatike) komandohet me pedal me këmbën e majtë		Gabim
1546	Funksioni i kutisë së ndërrimit të shpejtësisë është të modifikojë fuqinë që mund t'i jepet rrotave për të mposhtur më lehtë rezistencën kur ecni përpara		Saktë
1547	Mjetet e pajisura me një transmision automatik janë përgjithësisht me katër rrota aktive		Gabim
1548	Kutitë e ndërrimit të shpejtësisë automatike mund të kenë një maksimum prej 5 marshesh		Gabim
1549	Transmisioni kardanak transmeton lëvizjen nga kutia e shpejtësisë te çifti pinjon-koronë i diferencialit		Saktë
1550	Transmisioni kardanak mundëson transmetimin e lëvizjen në kënde dhe distancë të ndryshueshme, gjatë lëvizjes së mjetit		Saktë
1551	Transmisioni kardanak, në mjetet me gjatësi të mëdha, mund të përbëhet nga dy boshte		Saktë
1552	Transmisioni kardanak duhet të jetë sa më i rëndë që të transmetojë mirë lëvizjen		Gabim
1553	Transmisioni kardanak ka si pjesë përbërëse dhe reduktuesin e shpejtësisë (ridoton)		Gabim
1554	Transmisioni kardanak transmeton lëvizjen nga friksioni në kutinë shpejtësisë		Gabim
1555	Transmisioni kryesor (çifti pinjon-koronë) shërben për ti dhënë lëvizjen diferencialit nga transmisioni kardanak		Saktë
1556	Boshti kardanak i transmetimit duhet të jetë shumë i tensionuar për të parandaluar lëkundjen e diferencialit		Gabim
1557	Boshti kardanak i transmetimit nuk është i pranishëm nëse automjeti ka aktive rrotat e pasme dhe motorin të pozicionuar në pjesën e përparme		Gabim
1558	Boshti kardanak i transmetimit nuk është i pranishëm nëse automjeti nëse automjeti ka aktive rrotat e pasme dhe motorin të pozicionuar në pjesën e pasme		Saktë
1559	Boshti motorik dhe boshti kardanak i transmetimit janë dy emra të ndryshëm për të njëjtin element të automjetit		Gabim
1560	Transmisioni kryesor (çifti pinjon-koronë) ka në përbërje pinjonin, i cili e merr lëvizjen nga transmisioni kardanak		Saktë
1561	Transmisioni kryesor (çifti pinjon-koronë) merr lëvizjen nga diferenciali dhe ja transmeton tek semiakseve		Gabim
1562	Transmisioni kryesor (çifti pinjon-koronë) shërben për të rritur ose për të zvogëluar shpejtësinë e lëvizjes së mjetit në rrugë		Gabim
1563	Transmisioni kryesor (çifti pinjon-koronë) është pjesë e boshtit motorik		Gabim
1564	Regjistrimi i transmisioni kryesor (çiftit pinjon-koronë) realizon ingranimin e saktë ndërmjet dhëmbëve të pinjonit me atë të koronës		Saktë
1565	Regjistrimi i transmisioni kryesor (çiftit pinjon-koronë) bëhet nëpërmjet regjistrimit të kushinetave konike të pinjonit		Saktë
1566	Çifti koronë pinjon mund të montohet në vend të diferencialit		Gabim
1567	Regjistrimi i transmisioni kryesor (çiftit pinjon-koronë) bëhet në servise të specializuara		Saktë
1568	Regjistrimi i transmisioni kryesor (çiftit pinjon-koronë) kërkon regjistrimin e vetëm të njëjës kushinetës të koronës		Gabim
1569	Regjistrimi i transmisioni kryesor (çiftit pinjon-koronë) realizohet nga drejtuesi i mjetit, gjatë lëvizjes së mjetit		Gabim
1570	Regjistrimi i transmisioni kryesor (çiftit pinjon-koronë) nuk bëhet në asnjë rast, por vetëm ndërrohet çifti pinjon-koronë		Gabim
1571	Diferenciali ndryshon xhirot në rrotat aktive gjatë lëvizjes së mjetit në kthesa		Saktë
1572	Diferenciali ju lejon të ruani tërheqjen optimale të automjetit edhe në terrene me kapje (aderencë) të dobët të gomës		Gabim
1573	Diferenciali përmban vaj lubrifikues i cili duhet të zëvendësohet periodikisht		Saktë
1574	Diferenciali është një mekanizëm që parandalon rrëshqitjen e rrotave gjatë kthesës		Saktë
1575	Diferenciali është një mekanizëm që lejon rrotat e jashtme dhe të brendshme të rrotullohen me të njëjtën shpejtësi, gjatë kthesës		Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
1576	Diferenciali është një ndarës midis rrotave lëvizëse të të njëjtit aks		Saktë
1577	Diferenciali lejon që rrotat e makinës të kenë shpejtësi të ndryshme në raport me njëra -tjetrën		Saktë
1578	Diferenciali transmeton lëvizje në rrota përmes dy gjysmë boshteve (semiakseve)		Saktë
1579	Gjatë një kthese, diferenciali lejon të transferohet një pjesë të shpejtësisë së rrotullimit nga rrota e jashtme në atë të brendshme		Gabim
1580	Gjatë një kthese, diferenciali lejon të transferohet një pjesë të shpejtësisë së rrotullimit nga rrota e brendshme në atë të jashtme		Saktë
1581	Diferenciali transmeton lëvizjen në rrota me anë të semiakseve		Saktë
1582	Diferenciali punon në ambient lubrifikanti		Saktë
1583	Planetarët janë ingranazhe të diferencialit, që lidhen me semiakset nëpërmjet shlicave		Saktë
1584	Ingranazhet satelit të diferencialit, të ingranuar me ingranazhet planetar, kryejnë rrotullime rreth aksit të tyre, kur mjeti lëviz në kthesa		Saktë
1585	Lëvizja në diferencial transmetohet nga çifti pinjon-koronë		Saktë
1586	Diferenciali e merr lëvizjen nga semiakset		Gabim
1587	Diferenciali mund të jetë me një ose dy planetarë		Gabim
1588	Diferenciali shërben për ndryshimin e shpejtësisë së lëvizjes së mjetit		Gabim
1589	Blokozhi i diferencialit përdoret në rast xhirimi të njëres prej rrotave aktive, në baltë apo akull		Saktë
1590	Blokozhi i diferencialit kur vihet në punë realizon lidhjen e dy semiakseve		Saktë
1591	Blokozhi i diferencialit i vënë në funksionim bllokon rrotullimin e satelitëve, rreth aksit të tyre		Saktë
1592	Blokozhi i diferencialit përdoret në lëvizje normale me mjet dhe në rrugë të asfaltuar me kthesa		Gabim
1593	Blokozhi i diferencialit i vënë në funksionim bllokon rrotullimin e planetarëve dhe semiakseve		Gabim
1594	Blokozhi i diferencialit përdoret në të gjitha automjetet		Gabim
1595	Ndërprerja e lëvizjes në rrotat aktive mund të shkaktohet nga prishja e mekanizmit të komandimit të friksionit		Gabim
1596	Ndërprerja e lëvizjes në rrotat aktive mund të shkaktohet nga rënia e nivelit të vajit në kutinë e shpejtësisë		Gabim
1597	Automjetet me rrota të pasme aktive duhet domosdoshmërisht të kenë një motor të vendosur përpara		Gabim
1598	Automjetet me 4 rrota aktive nuk kanë friksion		Gabim
1599	Automjetet me akse drejtuese të dyfishta janë të pajisura me dy friksione të veçanta		Gabim
1600	Në përgjithësi, automjetet e rënda janë me rrota aktive të përparme		Gabim
1601	Motorët me djegie të brendshme kthejnë energjinë termike, në energji mekanike		Saktë
1602	Motori me djegie të brendshme që furnizon automjetet me energji duke transformuar energjinë mekanike në energji termike		Gabim
1603	Motori me djegie të brendshme punon duke thithur dhe ngjeshur vetëm ajrin		Gabim
1604	Energjia e nevojshme për funksionimin e motorit sigurohet nga përzierja e duhur e ajrit me lëndën djegëse që më pas ndizet		Saktë
1605	Motorët me djegie të brendshme shndërrojnë forcën lëvizëse në nxehtësi		Gabim
1606	Gjatë funksionimit të një motori, nxehtësia që nuk transformohet në energji mekanike transferohet në pjesën e jashtme, përmes sistemit të ftohjes, për të shmangur mbinxehjen		Saktë
1607	Në një motor me djegie të brendshme, përzierja benzinë-ajër ndodh në rezervuarin e karburantit		Gabim
1608	Motorët me ndezje të detyruar me benzinë dhe motorët me naftë janë të dy motorë me djegie të brendshme		Saktë
1609	Motorët me benzinë janë motorë me ndezje të detyruar		Saktë
1610	Fuqia e një motori tregohet në volt		Gabim
1611	Fuqia e një motori tregon punën e bërë në njësinë e kohës		Saktë
1612	Konsumi specifik i një motori përfaqëson sasinë e karburantit të kërkuar për të prodhuar një njësi të fuqisë		Saktë
1613	Në lartësi, ku presioni i ajrit është më i ulët, efikasiteti i motorit zvogëlohet, veçanërisht nëse është i tipit me djegie të brendshme		Gabim
1614	Në një lartësi, ku presioni i ajrit është më i ulët, efikasiteti i motorit zvogëlohet, veçanërisht nëse është i tipit Diesel		Gabim
1615	Në automjete përdoren kryesisht motorë me djegie të brendshme me katër kohë		Saktë
1616	Motorët me djegie të brendshme janë vetëm me dy kohë		Gabim
1617	Motorët me djegie të brendshme janë vetëm me një cilindër		Gabim
1618	Motori me djegie të brendshme ka në përbërje të tij mekanizmin bjellë-manivelë		Saktë

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
1619	Motori me djegie të brendshme ka në përbërje të tij sistemin e shpërndarjes së gazrave, i cili komandon futjen e ajrit dhe daljen e gazrave të djegies		Saktë
1620	Motori me djegie të brendshme ka në përbërje të tij sistemin e vaisjes		Saktë
1621	Motori me djegie të brendshme është i pajisur edhe me sistemin e ftohjes		Saktë
1622	Motori me djegie të brendshme ka në përbërje të tij friksionin		Gabim
1623	Motori me djegie të brendshme ka në përbërje të tij mekanizmat e transmetimit të lëvizjes		Gabim
1624	Motori me djegie të brendshme ka në përbërje të tij kutinë e shpejtësisë		Gabim
1625	Në motorin diesel me katër kohë, gjatë thithjes në cilindër hyn ajër i pastër nga valvola e thithjes		Saktë
1626	Në motorin diesel me katër kohë, lënda djegëse sprucohet me presion në dhomën e djegies dhe vetëndizet		Saktë
1627	Në motorin diesel me katër kohë, gjatë kohës së shtypjes ngjeshët vetëm ajër		Saktë
1628	Në motorin diesel, me katër kohë, të katër kohë kryhen në një rrotullim të boshtit motorik dhe 2 rrotullime të boshtit me gunga të shpërndarjes		Gabim
1629	Në motorin diesel, cikli i punës i të cilit realizohet në katër kohë, gjatë kohës së ngjeshjes bëhet djegia e lëndës djegëse		Gabim
1630	Në motorin diesel, cikli i punës i të cilit realizohet në katër kohë, gjatë thithjes në cilindër hyn përzierje djegëse nga valvola e thithjes		Gabim
1631	Cilindrat e një motori me djegie të brendshme duhet të jenë gjithmonë në numër çift		Gabim
1632	Cilindrat e një motori veprojnë si një dhomë zgjerimi gazi dhe si një udhëzues për pistonat		Saktë
1633	Cilindrat janë elementë të motorit që lëvizin brenda kanaleve të veçanta në bllokun e cilindrave		Gabim
1634	Cilindrat e një motori grupohen në një bllok të vetëm metalik të derdhur i cili emërtohet monoblok		Saktë
1635	Cilindrat janë pjesë mekanike karakteristike për motorët me djegie të brendshme		Saktë
1636	Lëvizja e pistonave është një lëvizje rrotulluese		Gabim
1637	Pistonat janë elementë tipike të motorëve elektrikë		Gabim
1638	Korsa e pistonit është e barabartë me dyfishin e rrezes së manivelës		Saktë
1639	Korsa e pistonit është më e vogël në motorët me xhiro të mëdha		Saktë
1640	Korsa e pistonit është sa diametri i brendshëm i cilindrit		Gabim
1641	Korsa e pistonit është më e vogël në motorët me xhiro të ulëta		Gabim
1642	Korsa e pistonit është e barabartë me rrezen e manivelës		Gabim
1643	Fashot elastike të kompresionit në motor pengojnë gazrat mbi piston që të dalin në sotokarter (nënkarter)		Saktë
1644	Fashot elastike të kompresionit në motor vendosen në kokën e pistonit, mbi syrin e tij		Saktë
1645	Kur konsumohen fashot elastike të kompresionit në motor rritet fuqia e motorit		Gabim
1646	Fashot elastike të kompresionit në motor shërbejnë për të realizuar rrëshqitjen e pistonit në cilindër		Gabim
1647	Fashot elastike të vajit në motor pengojnë kalimin e vajit në dhomën e djegies		Saktë
1648	Fashot elastike të vajit në motor shpërndajnë njëtrajtësisht shtresën e vajit në muret e cilindrit		Saktë
1649	Fashot elastike të vajit në motor vendosen në piston, poshtë fashove elastike të kompresionit		Saktë
1650	Fashot elastike të vajit në motor janë të vendosur në piston, mbi fashot elastike të kompresionit		Gabim
1651	Fashot elastike të vajit në motor janë me material duralumini		Gabim
1652	Fashot elastike të vajit në motor shërbejnë vetë për të penguar kalimin e gazeve në nënkarter		Gabim
1653	Bjella, në motorin me djegie të brendshme, shërben për kthimin e lëvizjes drejtvizore të pistonit, në lëvizje rrotulluese të boshtit motorik		Saktë
1654	Bjella, në motorin me djegie të brendshme, lidhet me boshtin motorik, në qafën e tij me bronzina		Saktë
1655	Bjella, në motorin me djegie të brendshme, lidhet me pistonin nëpërmjet spinotit		Saktë
1656	Bjella, në motorin me djegie të brendshme, shërben për lidhjen e boshtit motorik me boshtin me gunga të shpërndarjes		Gabim
1657	Bjella, në motorin me djegie të brendshme, lidhet me boshtin me gunga nëpërmjet spinotit		Gabim
1658	Bjellat lidhin pistonat me boshtin me gunga		Gabim
1659	Bjella, në motorin me djegie të brendshme, nuk laget nga vaji i motorit		Gabim
1660	Boshti motorik, në motorët me djegie të brendshme, e merr lëvizjen nga bjella		Saktë
1661	Koka e motorit (testata) mbyll dhomën e djegies nga ana e sipërme		Saktë
1662	Koka e motorit (testata) në brendësi ka kanale për qarkullimin e vajit dhe të lëngut ftohës		Saktë
1663	Koka e motorit (testata) mund të përmbajë dhe boshtin me gunga të shpërndarjes		Saktë
1664	Koka e motorit (testata) vendoset në pjesën e poshtme të bllokut të cilindrave		Gabim
1665	Koka e motorit (testata) në brendësi ka vetëm kanale për të qarkulluar vaj		Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
1666	Koka e motorit (testata) në brendësi ka vetëm kanale për të qarkulluar ujë		Gabim
1667	Nënkarteri (sotokarteri) shërben për mbylljen e bllokut të cilindrave nga poshtë dhe si depozitë e vajit të motorit		Saktë
1668	Nënkarteri (sotokarteri) montohet në bllokun e cilindrave		Saktë
1669	Nënkarteri (sotokarteri) është pjesa më e poshtme e motorit		Saktë
1670	Nënkarteri (sotokarteri) është pjesa më e sipërme e motorit		Gabim
1671	Nënkarteri (sotokarteri) shërben edhe si depozitë e vajit hidraulik të grupit të timonit		Gabim
1672	Nënkarteri (sotokarteri) montohet në testatë		Gabim
1673	Volanti është një disk i rëndë, i lidhur me boshtin motorik, i cili shërben si një bazë mbështetëse për diskun e friksionit, si dhe për të aktivizuar dhe për të rregulluar rrotullimin e boshtit motorik		Saktë
1674	Volanti përdoret për të rritur shpejtësinë e rrotullimit të motorit kur automjeti duhet të bëjë sforcime të mëdha (për shembull: në ngjitje të përpjetë)		Gabim
1675	Sistemi i shpërndarjes së gazeve realizon futjen e ajrit në cilindrat e motorit, sipas ciklit të punës të çdo cilindri		Saktë
1676	Sistemi i shpërndarjes së gazeve realizon nxjerrjen jashtë të gazrave të djegura në cilindrat e motorit		Saktë
1677	Boshti me gunga, në sistemin e shpërndarjes së gazrave, komandon valvolat e motorit për të hapur dhomat e djegies së motorit		Saktë
1678	Boshti me gunga, në sistemin e shpërndarjes së gazrave, mund të montohet në kokën e motorit (testatë)		Saktë
1679	Boshti me gunga, në sistemin e shpërndarjes së gazrave, vë në lëvizje boshtin motorik		Gabim
1680	Boshti me gunga, në sistemin e shpërndarjes së gazrave, merr lëvizjen nga kutia e shpejtësisë		Gabim
1681	Boshti me gunga kontrollon hapjen dhe mbylljen e valvolave		Saktë
1682	Në një motor me katër kohë, boshti motorik kryen dy rrotullime për të përfunduar një cikël të vetëm të funksionimit		Saktë
1683	Boshti me gunga, në sistemin e shpërndarjes së gazrave, montohet në nënkarter (sotokarter)		Gabim
1684	Si rezultat i prishjes së rripit të fazës, motori nuk ftohet më siç duhet		Gabim
1685	Në kokën e motorëve (testatën) me djegie të brendshme, përkatësisht për çdo cilindër janë të vendosura valvolat e thithjes dhe të shkarkimit		Saktë
1686	Valvolat, në motorët me djegie të brendshme, realizojnë mbyllje hermetike të cilindrit nga kontakti me atmosferën		Saktë
1687	Valvolat, në motorët me djegie të brendshme, mbyllin dhomat e djegies nga veprimi i sustave të montuara te bishti i tyre		Saktë
1688	Valvolat e thithjes, në motorët me djegie të brendshme, janë më të vogla se ato të shkarkimit		Gabim
1689	Valvolat, në motorët me djegie të brendshme, hapen dhe mbyllën nga veprimi i sustave të montuara te boshti me gunga		Gabim
1690	Valvolat, në motorët me djegie të brendshme, hapen dhe mbyllën nga sustat e valvolave		Gabim
1691	Lidhja e boshtit me gunga me boshtin motorik, për motorët e mjeteve të rënda, bëhet nëpërmjet rrotash të dhëmbëzuar (me ingranazhe)		Saktë
1692	Lidhja e boshtit me gunga me boshtin motorik duhet të realizojë vënien në fazë të motorit		Saktë
1693	Lidhja e boshtit me gunga me boshtin motorik bëhet nga specialistë përkatës të motorëve (motoristi)		Saktë
1694	Lidhja e boshtit me gunga me boshtin motorik, në të gjitha rastet, bëhet vetëm me rrip të dhëmbëzuar ose me zinxhir		Gabim
1695	Lidhja e boshtit me gunga me boshtin motorik mund të bëhet edhe me rrip trapezoidal		Gabim
1696	Rripi i fazës duhet të zëvendësohet çdo 20,000 kilometra		Gabim
1697	Lidhja jo e mirë e boshtit me gunga me boshtin motorik nuk ndikon në punën e motorit		Gabim
1698	Dalja nga faza e boshtit me gunga mund të shkaktojë ndezje fillestare me vështirësi dhe rënie të fuqisë së motorit		Saktë
1699	Dalja nga faza e boshtit me gunga mund të shkaktojë shtrembërimin e ndonjë valvole motori		Saktë
1700	Dalja nga faza e boshtit me gunga mund të shkaktojë dëmtim të pistonit, bjellës apo testatës		Saktë
1701	Dalja nga faza e boshtit me gunga të shpërndarjes së gazrave mund të shkaktojë gjithmonë vetëm fikje të motorit pa shkaktuar tjetër problem		Gabim
1702	Dalja nga faza e boshtit me gunga të shpërndarjes së gazrave mund të shkaktojë prishjen e pompës së vajit		Gabim
1703	Dalja nga faza e boshtit të shpërndarjes së gazrave mund të shkaktojë deformim të nënkarterit		Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
1704	Mos regjistrimi i mirë i valvolave të motorit mund të sjellë rritje të zhurmave të motorit		Saktë
1705	Mos regjistrimi i mirë i valvolave të motorit mund të sjellë nxehe të motorit, më tepër se zakonisht		Saktë
1706	Mos regjistrimi i mirë i valvolave të motorit mund të sjellë zvogëlim të presionit të përzierjes djegëse në fund të shtypjes		Saktë
1707	Mos regjistrimi i mirë i valvolave të motorit mund të sjellë rritje të fuqisë së motorit		Gabim
1708	Mos regjistrimi i mirë i valvolave të motorit mund të sjellë rritje të presionit të përzierjes djegëse në fund të shtypjes		Gabim
1709	Mos regjistrimi i mirë i valvolave të motorit mund të sjellë rritje të sasisë së përzierjes djegëse në cilindër		Gabim
1710	Sistemi i ushqimit të motorëve me djegie të brendshme shërben për furnizimin e motorit më ajër dhe lëndë djegëse		Saktë
1711	Sistemi i ushqimit të motorëve me djegie të brendshme dërgon lëndën djegëse dhe ajrin në dhomën e djegies në sasi dhe kohën e duhur		Saktë
1712	Sistemi i ushqimit të motorëve me djegie të brendshme ka në përbërje të tij edhe rezervuarin (depozitën) e lëndës djegëse		Saktë
1713	Sistemi i ushqimit të motorëve me djegie të brendshme është i njëjtë si për ato që punojnë me naftë dhe për ato që punojnë me benzinë		Gabim
1714	Sistemi i ushqimit të motorëve me djegie të brendshme dërgon vetëm ajër në dhomën e djegies		Gabim
1715	Sistemi i ushqimit të motorëve me djegie të brendshme shërben vetëm për furnizimin e motorit me lëndë djegëse		Gabim
1716	Sistemi i ushqimit i motorëve diesel ka në përbërje të tij pompën e naftës		Saktë
1717	Sistemi i ushqimit i motorëve diesel përbëhet edhe nga filtrat e naftës e të ajrit		Saktë
1718	Sistemi i ushqimit i motorëve diesel ka në përbërje të tij injektorët		Saktë
1719	Sistemi i ushqimit i motorëve diesel ka në përbërje të tij karburatorin		Gabim
1720	Sistemi i ushqimit i motorëve diesel ka në përbërje të tij bombolat e ajrit		Gabim
1721	Sistemi i ushqimit i motorëve diesel ka në përbërje të tij pompën e injeksionit të benzinës		Gabim
1722	Në një motor naftë, pompa e presionit të lartë ka për detyrë të thith naftën nga rezervuari dhe ta dërgojë atë me presion tek injektorët		Gabim
1723	Pompa e naftës e presionit të lartë dërgon naftën, në sasinë dhe kohën e duhur, në injektor		Saktë
1724	Pompa e naftës realizon presion të lartë të naftës që nëpërmjet tubave dërgohet në injektor		Saktë
1725	Pompa e naftës mund të jetë e tipit rrotative		Saktë
1726	Pompa e naftës është vetëm e tipit me komandim elektrik		Gabim
1727	Pompa e naftës e merr lëvizjen nga kutia e ndërrimit të shpejtësisë (kambios)		Gabim
1728	Pompa e naftës mbush me ajër bombolën e ajrit		Gabim
1729	Pompa e presionit të ulët (Pompaçia), në motorin diesel, shërben për dërgimin e lëndës djegëse nga depozita e naftës në pompën e presionit të lartë		Saktë
1730	Pompa e presionit të ulët (Pompaçia), në motorin diesel, bën pjesë në sistemin e ushqimit		Saktë
1731	Pompa e presionit të ulët (Pompaçia) në motorin diesel, shërben për dërgimin e lëndës djegëse, drejtpërdrejt në injektor		Gabim
1732	Pompa e presionit të ulët (Pompaçia), në motorin diesel, nuk bën pjesë në sistemin e ushqimit		Gabim
1733	Në një motor Diesel, pompa e karburantit me presion të ulët duhet të vendoset në automjet në një pikë larg burimeve të nxehtësisë, ose duhet të jetë e izoluar në mënyrë të përshtatshme		Gabim
1734	Në një motor Diesel, pompa e karburantit me presion të ulët është e pajisur me një pajisje anti-ngrirje që do të aktivizohet gjatë sezonit me temperatura të ftohta		Gabim
1735	Në një motor Diesel, pompa elektrike e presionit të ulët nuk mund të jetë kurrë në rezervuar për shkak të rrezikut të ndezjes së lëndës djegëse		Gabim
1736	Në një motor naftë, pompa e presionit të lartë në linjë realizon dhe qarkullimin e lëngut ftohës		Gabim
1737	Në një motor naftë, pompa e presionit të lartë thith karburantin dizel nga rezervuari		Gabim
1738	Në një motor Diesel, pompë e presionit të lartë lineare është e pajisur me elementë pompimi (një për secilin cilindër)		Saktë
1739	Në një motor Diesel, pompë e presionit të lartë lineare është e pajisur me një bosht me gunga		Saktë
1740	Në një motor Diesel, pompë e presionit të lartë lineare ka vetëm një element pompimi		Gabim
1741	Në një motor Diesel, pompë e presionit të lartë lineare gjithashtu dërgon vaj lubrifikues në pjesët në lëvizje të motorit		Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
1742	Në një motor Diesel, pompë e presionit të lartë lineare përdoret për të dërguar vaj me presion të lartë në elementët e frenimit të rrotave		Gabim
1743	Në një motor Diesel, pompë e presionit të lartë lineare e kontrolluar nga pedali i gazit, ju lejon të rregulloni sasinë e naftës që do të dërgohet tek injektorët		Saktë
1744	Në një motor Diesel, pompë e presionit të lartë lineare dërgon karburantin dizel me presion tek injektorët në sasinë e kërkuar nga pedali i gazit		Saktë
1745	Në një motor Diesel, pastrimi i injektorëve jo të rregullt mund të bëhet me motorin në punë, automjetin në marshin neutral dhe duke mbajtur shtypur për rreth dhjetë sekonda pedalin e përshejtuesit (gazit)		Gabim
1746	Në një motor Diesel, pastrimi i injektorëve jo të rregullt mund të bëhet duke lëvizur në të tatëpjetë me motorin fikur për disa qindra metra		Gabim
1747	Në një motor naftë, sasia e naftës së injektuar mund të rregullohet manualisht nga drejtuesi duke përdorur butonin vendosur në panelin e bordit (korskot)		Gabim
1748	Në një motor naftë, filtri i pompës së karburantit duhet të pastrohet pas çdo 10 furnizimeve me karburant		Gabim
1749	Në një motor Diesel, kur klima është shumë e ftohtë, pompa e karburantit duhet të aktivizohet nga drejtuesi me butonin e duhur, disa sekonda para ndezjes së motorit		Gabim
1750	Në një motor Diesel, nëse pompa e presionit të ulët ndalon së funksionuari, motori fiket		Saktë
1751	Në një motor naftë, nëse pompa e presionit të ulët funksionon në mënyrë elektrike, mund të zhytet në rezervuarin e karburantit		Saktë
1752	Në një motor Diesel, me pompë-injektor, nuk është e nevojshme prania e pompës së presionit të lartë		Saktë
1753	Tymi i një motori dizel është tregues i djegies së dobët dhe mund të shkaktohet nga depozitat në injektorët, të cilat parandalojnë pulverizimin e saktë të karburantit		Saktë
1754	Injektorët, në motorët diesel, shërbejnë për injektimin (futjen) e lëndës djegëse në dhomën e djegies		Saktë
1755	Injektorët, në motorët diesel, kanë si pjesë përbërëse sprucatorin		Saktë
1756	Injektorët, në motorët diesel, bëjnë pjesë në sistemin e ushqimit		Saktë
1757	Injektorët, në motorët diesel, montohen në piston		Gabim
1758	Injektorët, në motorët diesel, shërbejnë për të sprucuar naftën në kolektorin e thithjes		Gabim
1759	Injektorët - pompë të motorëve Diesel mund të komandohen vetëm mekanikisht		Gabim
1760	Në një motor me naftë, elektro-injektorët rrisin konsumin e automjetit sepse përdorin energji elektrike për funksionimin e tyre		Gabim
1761	Në një motor Diesel, elektro-injektorët përcaktojnë presionin e injektimit me anë të një suste të kalibruar		Gabim
1762	Në një motor Diesel, elektro-injektorët kryejnë një para-injektim dhe më pas injeksionin kryesor		Saktë
1763	Në një motor naftë, elektro-injektorët përdoren për të injektuar naftë në cilindra saktësisht si në koha ashtu edhe në sasi		Saktë
1764	Në një motor Diesel, elektro-injektorët marrin tension nga një bateri e dedikuar për ta		Gabim
1765	Në një motor Diesel, elektro-injektorët kontrollohen nga njësia e kontrollit elektronik dhe mund të injektojnë karburant në cilindra në më shumë se një herë në cikël pune		Saktë
1766	Në një motor naftë, elektro-injektorët komandohen mekanikisht nga boshti me gunga i pompës		Gabim
1767	Në një motor Diesel, elektro-injektorët janë më të saktë se injektorët mekanikë		Saktë
1768	Në një motor Diesel, elektro-injektorët, nëse nuk funksionojnë, mund të riparohen nga drejtuesi i mjetit kur ai është i pajisur me mjetet e duhura		Gabim
1769	Në një motor Diesel, injektorët ndalojnë injektimin e naftës dhjetë sekonda pasi motori është fikur		Gabim
1770	Në një motor Diesel, injektorët duhet të kontrollohen periodikisht		Saktë
1771	Në një motor naftë, injektorët injektojnë naftë në cilindra me presion të ulët		Gabim
1772	Në një motor naftë, injektorët injektojnë naftë në cilindra me presion të lartë		Saktë
1773	Në një motor Diesel, injektorët periodikisht injektojnë vaj lubrifikues në cilindër		Gabim
1774	Në një motor naftë, injektorët pompë të motorëve me naftë të gjeneratës së fundit kontrollohen në mënyrë elektronike		Saktë
1775	Injektorët - pompë të motorëve Diesel mund të komandohen vetëm mekanikisht		Gabim
1776	Në një motor Diesel, injektorët mund të kontrollohen mekanikisht ose elektronikisht		Saktë
1777	Në një motor naftë, injektorët furnizohen me lëndë djegës direkt nga pompa e presioni të lartë		Saktë
1778	Në një motor Diesel, injektorët janë të vendosur trupin e pompës së presionit të lartë		Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
1779	Në një motor naftë, injektorët janë të pajisur me një pajisje që pluhurizon karburantin dizel që hyn në cilindra		Saktë
1780	Në një motor naftë, injektorët shpesh kontrollohen elektronikisht nga një njësi kontrolli		Saktë
1781	Në një motor naftë, injektorët e çregjistruar shkaktojnë rritje të konsumit të karburantit		Saktë
1782	Në një motor naftë, injektorët e çregjistruar shkaktojnë më shumë ndotje të ajrit		Saktë
1783	Në një motor naftë, injektorët e çregjistruar sinjalizohen nga një dritë paralajmëruese jeshile në panelin e instrumenteve tregues të bordit (korskotit)		Gabim
1784	Në një motor Diesel me komandim elektronik, elektro-injektorët janë montuar në kokën e motorit		Saktë
1785	Në një motor naftë, kontrolli elektronik i injektorëve ju lejon të përcaktoni kohën dhe kohëzgjatjen e injektimit të naftës në cilindra		Saktë
1786	Në një motor me djegie të brendshme, pedali i gazit ndikon në pozicionin e valvolës flutur		Saktë
1787	Në një motor naftë me injeksion të drejtpërdrejtë, nafta injektohet direkt në cilindër		Saktë
1788	Në një motor naftë me injeksion të drejtpërdrejtë, nafta injektohet në një dhomë paraprake jashtë cilindrit		Gabim
1789	Në një motor naftë me injeksion indirekt, nafta injektohet direkt në cilindër		Gabim
1790	Në një motor naftë me injeksion indirekt, nafta injektohet në një paradhomë jashtë cilindrit		Saktë
1791	Në një motor naftë djegia e naftës ndodh nga mbinxehja e tij		Saktë
1792	Në një motor Diesel, elementët e pompimit të një pompë injeksioni në linjë dërgojnë naftën me presion të lartë direkt tek injektorët		Saktë
1793	Në një motor Diesel, elementët e pompimit të një pompë injeksioni në linjë duhet të çmontohen dhe pastrohen afërsisht çdo 30 ditë		Gabim
1794	Në një motor naftë, elementët e pompimit të një pompë injeksioni në linjë lëvizin nga boshti me gungë i pompës		Saktë
1795	Në një motor me naftë, elementët e pompimit të një pompë injeksioni në linjë janë të barabartë në numër me cilindrën		Saktë
1796	Në një motor me naftë, elementët e pompimit të një pompë injeksioni në linjë janë numër tek		Gabim
1797	Në një motor me naftë, elementët e pompimit nuk kërkojnë mirëmbajtje nëse përdoret bio-dizel		Gabim
1798	Në një motor naftë, sistemi i injektimit multijet (me shumë injeksione për një cikël pune) ul ndotjen e zhurmës të shkaktuar nga motori		Saktë
1799	Në një motor Diesel, sistemi i injektimit multijet arrin deri në 8 injeksione për një cikël pune		Saktë
1800	Në një motor naftë, sistemi i injektimit multijet (me shumë injeksione për një cikël pune) rrit fuqinë e motorit, duke rritur ndjeshëm konsumin e karburantit		Gabim
1801	Në një motor naftë, sistemi i injektimit multijet (me shumë injeksione për një cikël pune) përdoret vetëm në motorët me benzinë me turbo		Gabim
1802	Në një motor naftë, sistemi i injektimit multijet (me shumë injeksione për një cikël pune) ka gjithmonë dy injeksione të naftës në ciklin e funksionimit		Gabim
1803	Në një motor naftë, sistemi i injektimit multijet (me shumë injeksione për një cikël pune) lejon një ulje të konsumit		Saktë
1804	Në një motor naftë, sistemi i injektimit multijet (me shumë injeksione për një cikël pune) optimizon djegien e karburantit dizel në cilindra		Saktë
1805	Në një motor naftë, sistemi i injektimit multijet (me shumë injeksione për një cikël pune) zvogëlon ndotjen akustike nga zhurma e shkaktuar nga motori		Saktë
1806	Në një motor naftë, sistemi i injektimit multijet (me shumë injeksione për një cikël pune) zvogëlon ndotjen e ajrit të shkaktuar nga motori		Saktë
1807	Në një motor Diesel, sistemi i injektimit Common-rail është i pajisur me dy qarqe karburanti: një në presion të ulët dhe një në presion të lartë		Saktë
1808	Në një motor Diesel, sistemi i injektimit Common-rail është i pajisur me një njësi kontrolli që përpunon të dhënat e sensorë për të komanduar më mirë elektro-injektorët		Saktë
1809	Në një motor Diesel, sistemi i injektimit Common-rail është i pajisur me një pompë me presion të ulët që përcakton sasinë e karburantit që do të injektohet		Gabim
1810	Në një motor Diesel, sistemi i injektimit Common-rail është i pajisur me një pompë me presion të ulët që dërgon karburant direkt në elektro-injektorët		Gabim
1811	Në një motor Diesel, sistemi i injektimit Common-rail ka një tub grumbullues të përbashkët (Common-rail ose flaut) që përmban karburantin e dërguar nga pompa e presionit të lartë		Saktë
1812	Në një motor Diesel, sistemi i injektimit Common-rail me ndryshimin e numrit të rrotullimeve të boshtit motorik, sjell gjithmonë rritjen e presionit të injektimit		Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
1813	Në një motor Diesel, sistemi i injektimit Common-rail përdor ajër të kompresuar për të komanduar injektorët		Gabim
1814	Në një motor naftë, rregullatori i numrit të rrotullimeve të pompës mund të zëvendësohet nga kufizuesi i shpejtësisë		Gabim
1815	Sistemi i injektimit Common-rail injekton karburantin në kolektorin e thithjes për të marrë një përzierje më të mirë të lëndës djegëse me ajrin		Gabim
1816	"Common-rail" është një sistem injeksioni i kontrolluar elektronikisht për motorët me naftë, i cili lejon një presion shumë të lartë të injektimit		Saktë
1817	Common-rail është një pajisje që lejon injektimin e naftës në cilindra me presion shumë të lartë		Saktë
1818	Common-rail është një sistem injeksioni mekanik me naftë		Gabim
1819	Kontrolli elektronik i injektimit të karburantit është i mundur vetëm në motorët me ndezje të detyruar		Gabim
1820	Motorët me naftë nuk mund të pajisen me një turbokompresor sepse nafta nuk është shumë e ndezshme		Gabim
1821	Turbokompresori rrit fuqinë e motorit, por rrit konsumin e tij specifik		Gabim
1822	Turbokompresori rrit fuqinë e motorit, por përkeqëson performancën e tij		Gabim
1823	Turbokompresori mund të përdoret vetëm në motorët me cilindrata të vogël (maksimumi 2000 cm ³)		Gabim
1824	Motorët e pajisur me një turbokompresor duhet të kenë një zhurmëshues (marmitë) shtesë		Gabim
1825	Në një motor naftë, turbokompresori, duke shfrytëzuar gazrat e shkarkimit, lejon të rrisë sasinë e ajrit të futur në dhomën e djegies në mënyrë që të përmirësojë djegien dhe të rrisë fuqinë e dhënë, me të njëjtin konsum		Saktë
1826	Detyra e interkulerit është të ulë temperaturën e lëngut ftohës të motorit, veçanërisht në zonat me klimë të nxehtë		Gabim
1827	Detyra e interkulerit është të ulë temperaturën e ajrit që del nga turbokompresori, në mënyrë që të rrisë performancën e motorit		Saktë
1828	Turbokompresori rrit dendësinë e ajrit që futet në cilindra		Saktë
1829	Turbokompresori, në motorët me djegie të brendshme, shërben për të dërguar ajër me presion në dhomën e djegies		Saktë
1830	Turbokompresori, në motorët me djegie të brendshme, vihet në lëvizje nga gazrat e djegura që dalin nga motori		Saktë
1831	Turbokompresori, në motorët me djegie të brendshme, ka si pjesë përbërëse edhe turbinën		Saktë
1832	Turbokompresori, në motorët me djegie të brendshme, lubrifikohet me vajin e motorit		Saktë
1833	Turbokompresori, në motorët me djegie të brendshme, ka në përbërje të tij turbinën		Saktë
1834	Turbokompresori, në motorët me djegie të brendshme, shërben për të rritur sasinë e ajrit që futet në dhomën e djegies		Saktë
1835	Turbokompresori, në motorët me djegie të brendshme, shërben për të rikthyer gazrat e djegura në motor		Gabim
1836	Turbokompresori, në motorët me djegie të brendshme, realizon ulje të fuqisë së motorit		Gabim
1837	Turbokompresori, në motorët me djegie të brendshme, nuk ka ndikim në fuqinë e motorit		Gabim
1838	Turbokompresori, në motorët me djegie të brendshme, rikthen gazrat e djegies në dhomën e djegies		Gabim
1839	Turbokompresori, në motorët me djegie të brendshme, lubrifikohet me vajin e grupit të timonit		Gabim
1840	Për të njëjtën fuqi prodhimi, një motor me turbokompresor konsumon më pak karburant		Saktë
1841	Turbokompresori, në motorët me djegie të brendshme, përbëhet nga turbina që vihet në lëvizje nga boshti motorik		Gabim
1842	Turbina, në motorët me djegie të brendshme, vë në lëvizje kompresorin që dërgon ajrin me presion në dhomën e djegies		Saktë
1843	Turbina, në motorët me djegie të brendshme, vihet në lëvizje nga gazrat e djegura të motorit që dalin në atmosferë		Saktë
1844	Turbina, në motorët me djegie të brendshme, nëse është me defekt, çon në një zvogëlim të fuqisë së motorit		Saktë
1845	Turbina, në motorët me djegie të brendshme, nëse është me defekt, nuk e ul fuqinë e motorit		Gabim
1846	Turbina, në motorët me djegie të brendshme, shërben për të rritur efektin frenues të motorit		Gabim
1847	Turbina, në motorët me djegie të brendshme, është një pajisje që rikthen gazet e djegura në cilindër për rritjen e fuqisë		Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
1848	Ndryshe nga motori me benzinë, motori Diesel nuk kërkon filtër karburanti		Gabim
1849	Ndryshe nga motori me benzinë, motori Diesel nuk kërkon filtër ajri		Gabim
1850	Filtri i ajrit, në motorët me djegie të brendshme, duhet të ndërrohet periodikisht (sipas gjendjes tij)		Saktë
1851	Filtri i ajrit, në motorët me djegie të brendshme, shërben për pastrimin e ajrit që futet në dhomën e djegies nga papastërtitë		Saktë
1852	Filtri i ajrit, në motorët me djegie të brendshme, kur është i ndotur rrit konsumin e karburantit		Saktë
1853	Filtri i ajrit, në motorët me djegie të brendshme, nuk është e nevojshme të ndërrohet, kur mjete punon në rrugë të pastra		Gabim
1854	Filtri i ajrit, në motorët me djegie të brendshme, në rast se është i ri, ndikon në rritjen e ndotjes së mjedisit		Gabim
1855	Filtri i ajrit, në motorët me djegie të brendshme, nuk ndikon në konsumin e çiftit piston-cilindër		Gabim
1856	Motorët dizel janë të pajisur me një filtër ajri dhe një filtër naftë		Saktë
1857	Filtri i ajrit i një motori Diesel duhet të kontrollohet periodikisht, duke zëvendësuar fishekun e filtrit nëse është e nevojshme		Saktë
1858	Detyra e elementëve të sistemit të shkarkimit është të ulin temperaturën e gazrave të shkarkimit që dalin jashtë		Saktë
1859	Detyra e elementëve të sistemit të shkarkimit është të ulin presionin e gazrave të shkarkimit që dalin jashtë, në mënyrë që të zvogëlojnë zhurmën		Saktë
1860	Marmita duhet të zëvendësohet gjithmonë kur ka çarje ose thyerje, edhe nëse ato janë të vogla		Saktë
1861	Marmita duhet të zëvendësohet para çdo kontrolli teknik të automjetit		Gabim
1862	Marmita mund të riparohet me ngjitës silikon, pa pasur nevojë ta zëvendësoni atë		Gabim
1863	Në një motor Diesel, zhurmëshuesi duhet të zëvendësohet çdo dy vjet ose çdo 25,000 kilometra, sepse tymi i zi (bloza e karbonit) tenton ta bllokojë atë		Gabim
1864	Motorët me naftë nuk kërkojnë lubrifikim sepse nafta gjithashtu vepron si lubrifikues		Gabim
1865	Motorët me naftë nuk mund të pajisen me një turbokompresor sepse nafta nuk është shumë e ndezshme		Gabim
1866	Motorët me naftë të mjeteve të rënda të transportit të mallrave normalisht punojnë me shpejtësi të madhe se 4000-5000 rpm		Gabim
1867	Motorët dizel janë të pajisur me një filtër ajri dhe një filtër naftë		Saktë
1868	Motorët me naftë janë motorë me vetëndezje		Gabim
1869	Motorët me naftë janë të pajisur me një rregullator automatik të xhirove		Saktë
1870	Motorët me naftë janë gjithmonë të pajisur me injektor		Saktë
1871	Motori me naftë me injeksion indirekt është më pak ndotës sesa ai me injeksion të drejtpërdrejtë		Gabim
1872	Motori me naftë me injeksion indirekt ka një efikasitet më të mirë se ai me injeksion të drejtpërdrejtë		Gabim
1873	Motori Diesel thith ajrin ndërsa nafta futet në cilindra nga injektorët		Saktë
1874	Motori Diesel është i pajisur me një sistem ndezjeje që gjeneron shkëndijë në elektodat e kandelës		Gabim
1875	Motori Diesel funksionon numër xhirosh (rpm) më të lartë se motori i benzinës		Gabim
1876	Motori Diesel funksionon duke thithur dhe ngjeshur vetëm ajrin		Saktë
1877	Motori Diesel punon duke thithur dhe ngjeshur një përzierje ajri dhe naftë		Gabim
1878	Motori me naftë ka, në parim, një efikasitet më të mirë se motori i benzinës		Saktë
1879	Motori Diesel mund të jetë me injeksion të drejtpërdrejtë		Saktë
1880	Motori Diesel mund të jetë me injeksion indirekt		Saktë
1881	Motori Diesel ndryshon nga motori i benzinës në atë që ka një raport më të lartë të ngjeshjes		Saktë
1882	Motori Diesel ndryshon nga motori i benzinës në atë që funksionon me një numër dukshëm më të lartë të rrotullimeve		Gabim
1883	Motori Diesel ndryshon nga motori i benzinës në atë që punon shumë mirë edhe në temperatura të jashtme shumë të ulëta		Gabim
1884	Motori Diesel ndryshon nga motori i benzinës në atë që nuk mund të funksionojë pa kandela		Gabim
1885	Motori Diesel ndryshon nga motori i benzinës sepse djegia ndodh për shkak të ndezjes spontane të naftës		Saktë
1886	Motori Diesel ndryshon nga motori i benzinës sepse, në kohën e thithjes, futet vetëm ajër		Gabim
1887	Motori Diesel përdor përzierjen e krijuar në karburator		Gabim
1888	"Rrahja në testatë" tregon se pistonat godasin kokën e motorit (testatën) në çdo rrotullim të boshtit motorik		Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
1889	Numri i rrotullimeve në të cilat funksionon një motor me benzinë është përgjithësisht më i lartë se ai i një motori dizel		Saktë
1890	Në një motor naftë të zakonshëm, nafta injektohet në cilindra me një presion prej rreth 25 bar		Gabim
1891	Benzina ka një pikë ndezjeje më të ulët se nafta		Saktë
1892	Lënda djegëse naftë mund të përzihet me një përqindje të madhe të alkoolit, në mënyrë që të zvogëlohet ndotja atmosferike		Gabim
1893	Lënda djegëse naftë digjet më ngadalë se benzina		Gabim
1894	Bio- Diesel është një lëndë djegëse e prodhuar në rafineri që kanë certifikimin mjedisor të ndotjes së kufizuar		Gabim
1895	Bio - Diesel është një përzierje e naftës së zakonshme dhe vajrave vegjetal të djegshëm, i përdorur për të zvogëluar ndotjen e ajrit		Saktë
1896	Shkurtesa B10 identifikon një bio - naftë të përbërë nga 10% vaj vegjetal dhe 90% naftë		Saktë
1897	Shkurtesa B10 identifikon një lëndë djegëse të përbërë nga 10% naftë të zakonshme dhe 90% vaj vegjetal		Gabim
1898	Gazi natyror është më pak ndotës sesa benzina dhe nafta		Saktë
1899	Motorët me gaz kërkojnë më shumë mirëmbajtje sesa motorët me benzinë ose naftë		Gabim
1900	LPG është një lëndë djegëse me ndotje të ulët		Saktë
1901	LPG është një gaz i lëngshëm dhe prandaj mund të futet në rezervuarin e benzinës		Gabim
1902	LPG është një gaz i lëngshëm jo në presion		Gabim
1903	Automjetet me LPG mund të ketë vështirësi në ndezjen fillestare në të ftohtë		Saktë
1904	Motori me djegie të brendshme gjithashtu mund të punojë me gaz natyror ose LPG		Saktë
1905	Shkurtesa GPL identifikon gazin e lëngshëm të naftës		Saktë
1906	Motori elektrik është një motor me djegie të jashtme		Gabim
1907	Motori elektrik nuk është një motor me djegie të brendshme		Saktë
1908	Motori elektrik zakonisht ftohet me ajër		Saktë
1909	Motorët elektrikë janë motorë me vetëndezje		Gabim
1910	Një motor elektrik transformon energjinë elektromagnetike në forcë lëvizëse		Saktë
1911	Një motor elektrik transformon forcën lëvizëse në energji elektromagnetike		Gabim
1912	Automjetet elektrikë janë të pajisur me një kuti ndërrimi shpejtësie me tre marshe		Gabim
1913	Pesha e baterive ndikon negativisht në performancën e një automjeti me motor elektrik		Saktë
1914	Një automjet hibrid është gjithashtu i pajisur me një motor elektrik		Saktë
1915	Një automjet hibrid është i pajisur me dy motorë: një me djegie të brendshme dhe një me gaz natyror		Gabim
1916	Një automjet hibrid ka vetëm dy motorë elektrikë: një tension të lartë dhe një tension të ulët		Gabim
1917	Një automjet hibrid ka dy motorë, një me djegie të brendshme (benzinë ose naftë) dhe një elektrik		Saktë
1918	Automjetet hibride kanë motorë të përshtatshëm për funksionim vetëm në temperatura të larta të jashtme		Gabim
1919	Automjetet hibride janë më pak ndotëse se llojet e tjera, me përjashtim të atyre elektrike		Saktë
1920	Automjetet hibride duhet të kenë të katër rrotat aktive		Gabim
1921	Motorino është pjesë e sistemit elektrik të automjetit që shërben për lëshimin (ndezjen) e motorit		Saktë
1922	Sistemi i ndriçimit dhe sinjalizimit është pjesë e sistemit elektrik të automjetit		Saktë
1923	Siguresat janë pjesë e sistemit elektrik të automjetit që mbrojnë sistemin elektrik nga mbingarkesat		Saktë
1924	Gjeneratori (dinamo), i cili prodhon rrymë elektrike dhe karikon baterinë, është pjesë e sistemit elektrik të automjetit		Saktë
1925	Pjesë e sistemit elektrik të automjetit është vetëm bateria		Gabim
1926	Pjesë e sistemit elektrik të automjetit janë vetëm kandeletat		Gabim
1927	Mekanizmi i shpërndarjes së gazeve është pjesë e sistemit elektrik të automjetit		Gabim
1928	Volanti i motorit është pjesë e sistemit elektrik të automjetit		Gabim
1929	Elementët e sistemit të ndezjes së një motori diesel kanë për detyrë të prodhojnë një shkëndijë elektrike për të ndezur naftën		Gabim
1930	Elementët e sistemit të ndezjes së një motori me djegie të brendshme kanë për detyrë të prodhojnë një shkëndijë elektrike për të ndezur përzierjen ajër-benzinë		Saktë
1931	Sistemi elektrik i një automjeti është i ndarë në seksione, secila e mbrojtur nga siguresa e përkatëse		Saktë
1932	Sistemi elektrik i një automjeti të rëndë në përgjithësi punon me një tension prej 24 volt		Saktë

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
1933	Qarqet elektrike të automjetit nuk mbrohen nga siguresat		Gabim
1934	Siguresat me ngjyrë të kuqe mund të zëvendësohen vetëm nga punonjësit e serviseve të specializuara		Gabim
1935	Siguresat kanë një polaritet elektrik të veçantë dhe prandaj duhet të futen në folenë e tyre me një drejtim të saktë		Gabim
1936	Siguresat përbëhen nga një trup plastik brenda të cilit ka një tel metalik me diametër të caktuar, që shkrihet nëse rryma që kalon përmes tij tejkalon një vlerë kufi		Saktë
1937	Siguresat mund të zëvendësohen vetëm në autoserviseve		Gabim
1938	Vlera e tensionit të një sigurese është një numër i ndjekur nga shkronja e madhe U		Gabim
1939	Vlera e amperazhit të një sigurese është një numër i ndjekur nga shkronja e madhe A		Saktë
1940	Siguresa është një pajisje hidraulike që është në gjendje të mbrojë sistemin e lubrifikimit nga çdo presion i tepërt		Gabim
1941	Siguresa është një pajisje e aftë të ndërpresë kalimin e rrymës në një qark elektrik nëse tejkalon një prag të paracaktuar		Saktë
1942	Automjetet me një motor naftë nuk kanë siguresa sepse nuk kanë një sistem ndezjeje të përzierjes ajër-lëndë djegëse		Gabim
1943	Bateria e sistemit elektrik të një makine është një akumulator i rrymës alternative të tensionit të ulët		Gabim
1944	Bateria e sistemit elektrik të një automjeti është një gjenerator i rrymës alternative me tension të ulët		Gabim
1945	Bateria duhet të mbahet e pastër, e thatë dhe një graso e përshtatshme duhet të aplikohet periodikisht në terminalet e saj		Saktë
1946	Bateria furnizon energji vetëm motorin		Gabim
1947	Bateria furnizon me energji elektrike sistemin elektrik të automjetit, kur motori është i fikur		Saktë
1948	Bateria mbahet e ngarkuar nga alternatori		
1949	Bateria furnizon me energji elektrike motorinon gjatë ndezjes fillestare (lëshimit) së motorit		Saktë
1950	Bateria furnizon me energji elektrike sistemin elektrik edhe gjatë punës së motorit kur harxhimi i rrymës është më i madh se ai që prodhon dinamoja (gjeneratori)		Saktë
1951	Bateria furnizon me energji elektrike vetëm sistemin e ndriçimit dhe të sinjalizimit		Gabim
1952	Bateria, në motorët diesel, furnizon me energji elektrike vetëm kandeletat		Gabim
1953	Bateria furnizon me energji elektrike vetëm motorinon në motorët diesel		Gabim
1954	Bateria mund të lidhet në seri ose në paralel me një bateri tjetër për të arritur tensionin ose rrymën e nevojshme		Saktë
1955	Bateria është me kapacitet (amperazh) të tillë që përcaktohet nga motorino		Saktë
1956	Bateria gjatë ngarkimit kthen energjinë elektrike në energji kimike		Saktë
1957	Bateria gjendet në të gjitha mjetet rrugore		Gabim
1958	Rryma e furnizuar nga bateria është me tension të ulët dhe është e vazhdueshme		Saktë
1959	Rryma e furnizuar nga bateria është gjithmonë e vazhdueshme		Saktë
1960	Bateria prodhon energji elektrike me rrymë alternative		Gabim
1961	Disa bateri kërkojnë verifikim periodik dhe shtimin e mundshëm të ujit të distiluar		Saktë
1962	Bateria nuk bën pjesë në sistemin elektrik		Gabim
1963	Nëse ndizet drita paralajmëruese në panelin tregues të bordit (korskot) që tregon një bateri, kjo do të thotë që ju duhet të ndaleni menjëherë për të shmangur dëmtimin e sistemit elektrik		Gabim
1964	Uji i distiluar që i shtohet baterisë kur niveli është i ulët duhet të ketë një temperaturë mbi 25 °C		Gabim
1965	Në rast emergjence, lëngu ftohës me antifrizë mund të shtohet në elementët e baterisë		Gabim
1966	Dinamo (gjeneratori) shërben për të furnizuar me energji elektrike sistemin elektrik dhe për karikimin e baterisë kur motori është i ndezur		Saktë
1967	Dinamo (gjeneratori) vihet në lëvizje me rrip trapezoidal nga motori		Saktë
1968	Dinamo (gjeneratori) kthen energjinë mekanike në energji elektrike		Saktë
1969	Dinamo (gjeneratori) furnizon me energji elektrike motorinon		Gabim
1970	Dinamo (gjeneratori) prodhon energji elektrike edhe kur motori nuk është në punë		Gabim
1971	Dinamo (gjeneratori) shërben për lëshimin (ndezjen) e motorit		Gabim
1972	Disa motorë me naftë nuk kanë alternator		Gabim
1973	Alternatorët kanë një pajisje e cila kthen rrymën në dalje të tij të vazhduar		Saktë
1974	Alternatori është një pajisje që transformon energjinë mekanike në energji elektrike në formën e rrymës alternative		Saktë

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
1975	Alternatori është një gjenerator i rrymës alternative		Saktë
1976	Rryma e gjeneruar nga alternatori, në mënyrë që të grumbullohet nga bateria, duhet të korrigohet, pra të transformohet në rrymë vazhduar		Saktë
1977	Alternatori furnizon me rrymë motorin ose baterinë		Gabim
1978	Alternatori funksionon edhe kur motorin është i fikur		Gabim
1979	Alternatori e merr lëvizjen nga një ose më shumë rripa në formë V-je		Saktë
1980	Drejtuuesi duhet të kontrollojë periodikisht tensionin e karikimit të alternatorit		Gabim
1981	Në shumë raste, i njëjti rrip V që lë lëviz pulexhën e alternatorit gjithashtu vë në lëvizje pompën centrifugale të ftohësit		Saktë
1982	Funksionimi i alternatorit kontrollohet me anë të një dritë paralajmëruese të vendosur në panelin e bordit (korskot), e cila duhet të jetë e fikur		Saktë
1983	Kandeletat shërben për ngrohjen e ajrit në dhomën e djegies së motorëve diesel, para lëshimit të tyre		Saktë
1984	Kandeletat janë të lidhura me një llambë spiune në korskot, që jep informacion për mirëfunksionimin e tyre		Saktë
1985	Kandeletat e marrin rrymën elektrike nga bateria		Saktë
1986	Kandeleta vendoset në të gjitha llojet e automjeteve		Gabim
1987	Kandeleta është në funksiononim edhe kur motori punon		Gabim
1988	Kandeleta e merr rrymën elektrike nga dinamoja		Gabim
1989	Në disa motorë me naftë më të fuqishëm, kandeletat zëvendësohen me kandelet		Gabim
1990	Motorino furnizohet me tension nga alternatori		Gabim
1991	Motorino e ndezjes nuk është i pranishëm në automjetet me transmetim automatik		Gabim
1992	Motorino furnizohet me tension nga bateria		Saktë
1993	Motorino shërben për të bërë ndezjen fillestare (lëshimin) të motorit të automjetit		Saktë
1994	Motorino ushqehet me energji elektrike nga bateria		Saktë
1995	Në rast emergjence, motorino mund të aktivizohet me një levë të veçantë		Gabim
1996	Në varësi të fuqisë së motorit, zgjidhet edhe fuqia e motorinos që do shërbej për ndezjen e tij		Saktë
1997	Motorino vihet në lëvizje nga motori		Gabim
1998	Motorino shërben për prodhimin e rrymës elektrike		Gabim
1999	Motorino duhet të jetë në punë gjatë gjithë kohës që motori qëndron i ndezur		Gabim
2000	Ndryshe nga motori me benzinë, motori Diesel nuk kërkon filtër karburanti		Gabim
2001	Ndryshe nga motori me benzinë, motori Diesel nuk kërkon filtër ajri		Gabim
2002	Për të njëjtën fuqi prodhimi, një motor me turbokompor konsumon më pak karburant		Saktë
2003	Si rezultat i prishjes së rripit të fazës, motori nuk ftohet më siç duhet		Gabim
2004	Çifti koronë pinjon mund të montohet në vend të diferencialit		Gabim
2005	Disa bateri kërkojnë verifikim periodik dhe shtimin e mundshëm të ujit të distiluar		Saktë
	TEMA XII. SISTEMI I LUBRIKIMIT DHE SISTEMI I FTOHJES. MBROJTJA NGA NGRICA		
2006	Sistemi i ftohjes, së motorëve me djegie të brendshme, shërben për të siguruar temperaturën optimale gjatë punës së motorit		Saktë
2007	Sistemi i ftohjes, së motorëve me djegie të brendshme, ka për qëllim të mbajë temperaturën konstante të motorit gjatë punës		Saktë
2008	Radiator, ventilatori dhe pompa centrifugale janë elementë përbërës të sistemit të ftohjes së motorit		Saktë
2009	Në disa tipe motorësh me djegie të brendshme, ftohjen e tyre realizohet vetëm me anë të ajrit		Saktë
2010	Ftohja e motorëve me djegie të brendshme, realizohet vetëm me anë të ajrit		Gabim
2011	Sistemi i ftohjes, së motorëve me djegie të brendshme, realizon ftohjen e tyre vetëm me anë të qarkullimit të vajit		Gabim
2012	Sistemi i ftohjes, së motorëve me djegie të brendshme, shërben vetëm për ftohjen e bllokut të cilindrave		Gabim
2013	Pompa e qarkullimit të lëngut ftohës është pjesë e sistemit të ftohjes së motorëve me djegie të brendshme		Saktë
2014	Qarku i sistemit të ftohjes është ndërtuar në atë mënyrë që të lejojë qarkullimin e lëngut ftohës në një temperaturë që mund të jetë edhe më e lartë se 100 ° C		Saktë
2015	Funksionimi i saktë i sistemit të ftohjes kontrollohet me anë të një dritë paralajmëruese dhe një termometri të vendosur në panelin e instrumenteve tregues të automjetit		Saktë

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
2016	Lëngu i sistemit të ftohjes ka një temperaturë të lartë vlimi (mbi 100 ° C) dhe një temperaturë të ulët ngrirjeje (më pak se 0 ° C)		Saktë
2017	Lëngu i sistemit të ftohjes mund të zëvendësohet me ujë, në rast nevojë urgjente		Saktë
2018	Lëngu i sistemit të ftohjes duhet të ketë një temperaturë të ulët ngrirjeje dhe një temperaturë të ulët vlimi		Gabim
2019	Ftohësi duhet të ketë një temperaturë të ulët ngrirjeje, një temperaturë të lartë vlimi dhe veti jo gërryerës		Saktë
2020	Lëngu ftohës qarkullohet nga një pompë centrifugale		Saktë
2021	Radiatori është elementi që lejon që lëngu në qarkun e ftohjes të mos kalojë një temperaturë e cila është e dëmshme për motorin		Saktë
2022	Radiatori është një shkëmbyes nxehtësie ujë-ajër		Saktë
2023	Radiatori përdoret për të ngrohur kabinën e pasagjerëve të automjetit duke përdorur nxehtësinë e prodhuar nga funksionimi i motorit		Gabim
2024	Parregullsia kryesore që sjell mbinxehja e motorit, është rritja e konsumit të karburantit		Gabim
2025	Parregullsia kryesore që sjell mbinxehja e motorit, është rritja e emetimeve ndotëse të motorit		Gabim
2026	Parregullsia kryesore që sjell mbinxehja e motorit, është bërja e pamundur e përdorimit të sistemit të ajrit të kondicionuar		Gabim
2027	Termostati i sistemit të ftohjes mund të aktivizohet nga drejtuesi me anë të një çelësi të vendosur në panelin e instrumenteve		Gabim
2028	Ventilatori i sistemit të ftohjes funksionon vetëm kur automjeti është i palëvizshëm me motorin në punë		Gabim
2029	Ventilatori i sistemit të ftohjes nuk mund të aktivizohet nëse temperatura e ajrit të jashtëm është nën 0 ° C		Gabim
2030	Ventilatori i sistemit të ftohjes nuk mund të aktivizohet nëse shpejtësia e automjetit është më e lartë se 80 km / orë		Gabim
2031	Ventilatori i sistemit të ftohjes shërben për të përshpejtuar ftohjen e lëngut që kalon nëpër radiator		Saktë
2032	Ventilatori i sistemit të ftohjes ndizet automatikisht kur temperatura e ftohësit tejkalon një temperaturë të caktuar		Saktë
2033	Ventilatori i sistemit të ftohjes ndalon automatikisht kur temperatura e ftohësit bie nën një temperaturë të caktuar		Saktë
2034	Ventilatori i sistemit të ftohjes aktivizohet nga drejtuesi me anë të një ndërprerësi të vendosur në kabinën		Gabim
2035	Ventilatori i sistemit të ftohjes është i fikur në tatëpjeta (zbritje) të gjata		Gabim
2036	Në rast të temperaturës së lartë të qarkut të ftohjes, është praktikë e mirë të hidhni një kovë me ujë shumë të ftohtë në motor		Gabim
2037	Në rast të temperaturës së lartë të qarkut të ftohjes, është praktikë e mirë që menjëherë të hapni kapakun e radiatorit		Gabim
2038	Në rast të mosfunksionimit të termostatit të sistemit dhe mbinxehjes së lëngut ftohës, mjafton të hiqni vetë termostatin		Gabim
2039	Në një sistem ftohës me lëng, lëngu transferon nxehtësinë e hequr nga motori në atmosferë përmes radiatorit		Saktë
2040	Në sistemet moderne të ftohjes së automjeteve, nuk lejohet përdorimi i ujit si zëvendësues i lëngut ftohës		Gabim
2041	Temperatura tepër e lartë e lëngut ftohës të një motori mund të krijohet për shkak të formimit të grumbullimit të zmërçit në tubat e radiatorit		Saktë
2042	Ventilatori i radiatorit funksionon për të parandaluar ngrirjen e lëngut ftohës		Gabim
2043	Në sistemet moderne të ftohjes së automjeteve nuk është kurrë e nevojshme të kontrolloni nivelin e lëngut pasi sistemi i ftohjes është i mbyllur		Gabim
2044	Në zonat me klima të ftohta është thelbësore të vendosni antifrizë në qarkun e sistemit të ftohjes		Saktë
2045	Në motorët e automjeteve artikularë, ftohja e detyruar me ajër është më e përdorur se ftohja e detyruar me lëng		Gabim
2046	Në motorët e automjeteve artikularë, temperatura e ftohësit nuk duhet të kalojë kurrë 80 ° C		Gabim
2047	Uji ose lëngu i ftohtë nuk duhet të shtohet në radiator kur motori është shumë i nxehtë		Saktë
2048	Zakonisht ftohësi i motorit është ujë i distiluar		Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
2049	Për të kufizuar konsumin, motori duhet të punojë gjithmonë në temperatura të ulëta (maksimumi 60 ° C)		Gabim
2050	Kur aktivizohet ventilatori i sistemit të ftohjes, në të njëjtën kohë çaktivizohet kompresori i sistemit të ajrit të kondicionuar në zonën e pasagjerëve		Gabim
2051	Kur temperatura e ftohësit është shumë e lartë, drita paralajmëruese në panelin e kontrollit (korskot) fiket		Gabim
2052	Nëse temperatura e lëngut ftohës rritet shumë, kjo varet vetëm nga mënyra e drejtimit të automjetit		Gabim
2053	Nëse temperatura e ftohësit bëhet shumë e lartë, kjo varet vetëm nga shkaku i mungesës së ftohësit në rezervuar		Gabim
2054	Edhe ventilatori i motorit me djegie të brendshme është pjesë e sistemit të ftohjes së tij		Saktë
2055	Radiatori është pjesë e sistemit të ftohjes së motorëve me djegie të brendshme		Saktë
2056	Termostati, pas ndezjes, nëpërmjet qarkullimit të shkurtër të lëngut, siguron nxehjen e shpejt të motorit me djegie të brendshme deri në temperaturën optimale të punës		Saktë
2057	Valvola "avull ajër" e kapakut të radiatorit është pjesë e sistemit të ftohjes së motorëve me djegie të brendshme		Saktë
2058	Pompa e vajit është pjesë e sistemit të ftohjes së motorëve me djegie të brendshme		Gabim
2059	Boshti i shpërndarjes është pjesë e sistemit të ftohjes së motorëve me djegie të brendshme		Gabim
2060	Kompresori i ajrit është pjesë e sistemit të ftohjes së motorëve me djegie të brendshme		Gabim
2061	Në sistemin e ftohjes së motorëve me djegie të brendshme, ventilatori realizon ftohjen e radiatorit me anë të lëvizjes së detyruar të ajrit		Saktë
2062	Kapaku i radiatorit nxjerr avuj jashtë kur është rritur shumë presioni i lëngut ftohës në motor		Saktë
2063	Kapaku i radiatorit bën që të hyjë ajër në radiator, kur është krijuar vakum për shkak të ftohjes së lëngut në motor		Saktë
2064	Përdorimi i ujit të zakonshëm për ftohjen e motorit nuk e dëmton radiatorin e tij		Gabim
2065	Pompa e lëngut ftohës, në motorët me djegie të brendshme, dërgon lëngun me presion në radiator		Gabim
2066	Në sistemin e ftohjes, së motorëve me djegie të brendshme, rekomandohet përdorimi i ujit natyral të zakonshëm		Gabim
2067	Termostati, në sistemin e ftohjes, shërben për të rregulluar sasinë e lëngut ftohës që kalon për ftohje në radiator		Saktë
2068	Termostati, në sistemin e ftohjes, ndalon kalimin e lëngut ftohës në radiator kur motori është i ftohtë		Saktë
2069	Motori me djegie të brendshme i automjetit mund të nxehtet në mënyrë të menjëhershme nëse termostati nuk funksionon		Saktë
2070	Termostati, në sistemin e ftohjes, lejon lëngun ftohës të kalojë në radiator kur motori është i ftohtë		Gabim
2071	Termostati, në sistemin e ftohjes, vendoset përpara pompës së lëngut ftohës		Gabim
2072	Sistemi i vaisjes, në motorët me djegie të brendshme, shërben për të dërguar vajin lubrifikues në pjesët e lëvizshme të motorit		Saktë
2073	Sistemi i vaisjes, në motorët me djegie të brendshme, mund të jetë i kombinuar, duke e dërguar vajin me presion dhe me spërkatje		Saktë
2074	Sistemi i vaisjes, në motorët me djegie të brendshme, zvogëlon fërkimin, largon nxehtësinë dhe mbeturinat midis pjesëve të lëvizshme të motorit		Saktë
2075	Sistemi i vaisjes, në motorët me djegie të brendshme, është vetëm me spërkatje		Gabim
2076	Sistemi i vaisjes, në motorët me djegie të brendshme, shërben edhe për vaisjen e kutisë së shpejtësisë		Gabim
2077	Sistemi i vaisjes, në motorët me djegie të brendshme, shërben vetëm për ftohjen e motorit		Gabim
2078	Pompa e vajit është pjesë përbërëse e sistemit të vaisjes së detyruar të motorëve me djegie të brendshme		Saktë
2079	Filtri i vajit është pjesë përbërëse e sistemit të vaisjes së detyruar të motorëve me djegie të brendshme		Saktë
2080	Valvola e sigurisë për qarkullimin e vajit, në rast bllokimi të filtrit të vajit, është pjesë përbërëse e sistemit të vaisjes së detyruar të motorëve me djegie të brendshme		Saktë
2081	Pompa hidraulike e grupit të timonit është pjesë përbërëse e sistemit të vaisjes së detyruar të motorëve me djegie të brendshme		Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
2082	Pompa e lëngut ftohës është pjesë përbërëse e sistemit të vasisjes së detyruar të motorëve me djegie të brendshme		Gabim
2083	Turbokompresori është pjesë përbërëse e sistemit të vasisjes së detyruar të motorëve me djegie të brendshme		Gabim
2084	Pompa e vajit, në motorët me djegie të brendshme, dërgon vajin me presion në qafat e bangove e bjellave të boshtit motorik		Saktë
2085	Pompa e vajit, në motorët me djegie të brendshme, si rregull, e merr lëvizjen nga boshti motorik		Saktë
2086	Pompa e vajit, në motorët me djegie të brendshme, mund të vihet në lëvizje me një nga ingranazhet e distribucionit		Saktë
2087	Pompa e vajit, në motorët me djegie të brendshme, dërgon vajin me presion vetëm në qafat e boshtit të shpërndarjes		Gabim
2088	Pompa e vajit, në motorët me djegie të brendshme, vihet në lëvizje nga rripi i dinamos		Gabim
2089	Pompa e vajit, në motorët me djegie të brendshme, vihet në lëvizje direkt nga volanti i motorit		Gabim
2090	Vaji lubrifikues i motorëve duhet të ketë temperaturë ngrirje të ulët		Saktë
2091	Vaji lubrifikues i motorëve duhet të ketë viskozitetin e nevojshëm edhe gjatë punës		Saktë
2092	Vaji lubrifikues i motorëve përcaktohet nga konstruktori (ndërtuesi), në varësi të llojit të motorit		Saktë
2093	Vaji lubrifikues i motorëve përdoret edhe në varësi të stinës		Saktë
2094	Vaji lubrifikues i motorëve duhet të ketë përmbajtje uji		Gabim
2095	Vaji lubrifikues i motorëve duhet të jetë i njëjtë si në periudhën e dimrit, ashtu edhe në periudhat e nxehta		Gabim
2096	Vaji lubrifikues i motorëve duhet të ketë temperature flakërimi (ndezje) të ulët		Gabim
2097	Vaji lubrifikues i motorëve duhet të ndërrohet sa më shpesh edhe pse gjendja e tij mund të jetë e mirë		Gabim
2098	Vaisja e motorëve me djegie të brendshme, për një pjesë detalesh, realizohet me dërgim të detyruar të vajit me anë të pompës së vajit		Saktë
2099	Vaisja e motorëve me djegie të brendshme, për një pjesë detalesh, mund të bëhet me dërgim të vajit me spërkatje		Saktë
2100	Vaisja e motorëve me djegie të brendshme ndikon në jetëgjatësinë e motorit		Saktë
2101	Vaisja e motorëve me djegie të brendshme nuk është e detyruar për të gjitha llojet e motorëve me djegie të brendshme		Gabim
2102	Vaisja e motorëve me djegie të brendshme realizohet në të gjitha rastet, vetëm me anë të spërkatjes nga rrotullimi i mekanizmit bjellë-manivelë		Gabim
2103	Vaisja e motorëve me djegie të brendshme nuk ndikon në jetëgjatësinë e motorit		Gabim
2104	Ndryshe nga vaji i lubrifikimit të motorit, vaji i kutisë së shpejtësisë nuk zëvendësohet kurrë sepse nuk i nënshtrohet temperaturave të larta gjatë funksionimit		Gabim
2105	Detyra e sistemit të lubrifikimit është të rrisë fërkimin, përndryshe pjesët mekanike nuk mund të kryejnë funksionin e tyre		Gabim
2106	Këshillohet që të mos përdorni vajin specifik për motorët me djegie të brendshme me benzinë në motorët naftë dhe anasjelltas		Saktë
2107	Këshillohet që periodikisht të kulloni vajin nga motori, ta filtroni me një sitë të pastër dhe pastaj ta rifusni përsëri në motor		Gabim
2108	Këshillohet që të zëvendësoni vajin e lubrifikimit të motorit sipas kohës dhe distancave të rekomanduara nga prodhuesi i motorit		Saktë
2109	Ekzistojnë dy lloje të filtrave të vajit: një për sezonin e dimrit dhe një për sezonin e verës		Gabim
2110	Niveli i vajit është e nevojshme që të kontrollohet periodikisht duke përdorur shufrën përkatëse, por jo para se të lini motorin në punë për të paktën 15 minuta		Gabim
2111	Këshillohet që të mos shtoni sasinë e vajit në motor me vaj të një lloji dhe karakteristikash të ndryshme nga ato që ai përmban		Saktë
2112	Sistemi i lubrifikimit të sigurojë lubrifikim efektiv të të gjithë rripave të transmetimit të lëvizjes në motor		Gabim
2113	Nënkarteri, filtri dhe treguesi i presionit janë elementë përbërës të sistemit të lubrifikimit		Saktë
2114	Vajrat lubrifikues mund të përmbajnë aditivë kimikë		Saktë
2115	Vajrat lubrifikues mund të jenë minerale ose sintetikë		Saktë
2116	Sistemi i lubrifikimit të motorëve me djegie të brendshme me naftë kanë për qëllim, ndër të tjera, të lubrifikojnë pompën e karburantit		Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
2117	Në automjet e rënda përdoren tre lloje filtrash vaji: me karton, me karbon aktiv dhe me rrjetë metalike		Gabim
2118	Konsumi i vajit të motorit rritet me konsumimin e fashove të pistonit		Saktë
2119	Kontrolli i nivelit të vajit të motorit duhet të bëhet gjithmonë me motorin të fikur për disa minuta		Saktë
2120	Kontrolli periodik i nivelit të vajit lubrifikues mund të bëhet vetëm në servise të autorizuara		Gabim
2121	Kontrolli periodik i nivelit të vajit lubrifikues mund të kryhet vetëm nëse automjeti ka pjesën e përparme më të lartë se pjesa e pasme		Gabim
2122	Niveli i vajit lubrifikues të motorit kontrollohet me anë të një matësi presioni (manometri) të instaluar të vendosur në panelin e instrumenteve tregues të automjetit		Gabim
2123	Vajrat lubrifikues fillon të qarkullojë në motor vetëm pasi temperatura e lëngut ftohës të ketë kaluar 65 ° C		Gabim
2124	Matësi i presionit të vajit në panelin e instrumenteve (korskot) tregon sasinë e vajit që përmbahet në nënkarter		Gabim
2125	Shtimi i sasisë së vajit lubrifikues në një motor Diesel nuk lejohet, sepse nëse niveli është i ulët ai duhet të zëvendësohet plotësisht		Gabim
	TEMA XIII. NJOHURI MBI METODAT PËR IDENTIFIKIMIN E SHKAQEVE TË DEFEKTEVE TË ELEMENTËVE TË SISTEMIT TË DREJTIMIT DHE SISTEMIT TË SHUARJES SË LËKUNDJEVE (AMORTIZIMIT)		
2126	Balestrat e automjetit shërbejnë për lidhjen elastike të shasisë me urat		Saktë
2127	Balestrat zvogëlojnë ngarkesat goditëse që transmetohen nga ura në shasi		Saktë
2128	Balestrat e automjetit sigurojnë lidhje të ngurtë (jo elastike) të shasisë me urat		Gabim
2129	Balestrat e automjetit mundësojnë shuarjen e lëkundjeve		Gabim
2130	Balestrat e automjetit duhet të vaiseen që të mos dobësohen		Gabim
2131	Balestrat e automjetit shërbejnë për shpërndarjen e mirë të ngarkesës nëpër rrota		Gabim
2132	Amortizatorët e automjetit shuajnë lëkundjet e shasisë të krijuar nga balestrat		Saktë
2133	Amortizatorët e automjetit vendosen ndërmjet shasisë dhe urave		Saktë
2134	Amortizatorët e automjetit rrisin komoditetin (rehatinë) e njerëzve gjatë udhëtimit me mjet		Saktë
2135	Amortizatorët e automjetit rrisin stabilitetin (qëndrueshmërinë) e mjetit gjatë udhëtimit		Saktë
2136	Amortizatorët e automjetit zvogëlojnë ngarkesat goditëse që merr rrota nga rruga		Gabim
2137	Amortizatorët e automjetit kur janë të konsumuar, rrisin stabilitetin (qëndrueshmërinë) e mjetit në lëvizje		Gabim
2138	Amortizatorët e automjetit nuk ndihmojnë në ruajtjen e balestrave		Gabim
2139	Stabilizatorët e automjetit rregullojnë shpërndarjen e ngarkesës në rrotat e të njëjtit aks, kur rruga ka pjerrësi anësore		Saktë
2140	Stabilizatorët e automjetit vendosen ndërmjet shasisë dhe urave		Saktë
2141	Stabilizatorët e automjetit mbrojnë balestrat nga mbingarkesat që vijnë nga vendosja e gabuar e ngarkesës		Saktë
2142	Stabilizatorët e automjetit rrisin animin e karrocisës, në rastin e vendosjes jo të rregullt të ngarkesës		Gabim
2143	Stabilizatorët e automjetit shërbejnë për të transmetuar lëkundjet e urave në shasi		Gabim
2144	Stabilizatorët e automjetit shërbejnë për të zbutur ngarkesat goditëse në ura gjatë përplasjes së mjetit		Gabim
2145	Në temperatura të ulëta, vaji i amortizatorëve hidraulikë duhet të përzihet me antifrizë		Gabim
2146	Amortizatorët e përparmë mund të hiqen nga automjeti, pa cenuar nivelin e sigurisë		Gabim
2147	Amortizatorët janë vetëm të tipit mekanikë		Gabim
2148	Amortizatorët hidraulikë përdorin një vaj të veçantë, rezistent ndaj temperaturave të larta		Saktë
2149	Amortizatorët nuk përdoren në automjete, me masë maksimale mbi 7 tonë		Gabim
2150	Amortizatorët e dobësuar (të rënë) duke ulur qendrën e gravitetit rrisin qëndrueshmërinë e automjetit në lëvizje		Gabim
2151	Amortizatorët janë të lidhur në një rënë anë me shasinë dhe nga ana tjetër me aksin e rrotave		Saktë
2152	Amortizatorët, nëse shkarkohen, nuk i largojnë siç duhet lëkundjet e balestrave		Gabim
2153	Elementët e sistemit të shuarjes së lëkundjeve (amortizimit) të mjetit duhet të regjistrohen përpara se të niseni në ndonjë udhëtim të gjatë		Gabim
2154	Elementët e sistemit të shuarjes së lëkundjeve (amortizimit) aktivizohen kur shpejtësia e mjetit arrin mbi 50 km / orë		Gabim
2155	Elementët e sistemit të shuarjes së lëkundjeve (amortizimit) nuk duhet të mbingarkohen		Saktë

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
2156	Elementët e sistemit të shuarjes së lëkundjeve (amortizimit) nuk kërkojnë mirëmbajtje, sepse ato janë projektuar të jenë efikase për të gjithë jetën e automjetit		Gabim
2157	Elementët e sistemit të shuarjes së lëkundjeve (amortizimit) përdoren për të parandaluar bllokimin e rrotave të pasme gjatë frenimit		Gabim
2158	Elementët e sistemit të shuarjes së lëkundjeve (amortizimit) shërbejnë për të parandaluar mbinxehjen e gomave		Gabim
2159	Elementët e sistemit të shuarjes së lëkundjeve (amortizimit) shërbejnë për të mbajtur kapjen (aderencën) e rrotave të veçanta, sa më konstante		Saktë
2160	Elementët e sistemit të shuarjes së lëkundjeve (amortizimit) shërbejnë për të reduktuar efektet e ndikimeve të transmetuara në automjet nga ndryshimet dhe parregullsitë e rrugës		Saktë
2161	Elementët e sistemit të shuarjes së lëkundjeve (amortizimit) për të zvogëluar ose kufizuar xhirimin në vend të rrotave		Saktë
2162	Elementët e sistemit të shuarjes së lëkundjeve (amortizimit) të mjetit shërbejnë për të rritur këndin e kthimit të tij		Gabim
2163	Elementët e sistemit të shuarjes së lëkundjeve (amortizimit) dëmtohen më lehtë nëse ngarkesa nuk është rregulluar siç duhet		Saktë
2164	Elementët e sistemit të shuarjes së lëkundjeve (amortizimit) mund të çaktivizohen nga drejtuesi në çdo kohë		Gabim
2165	Elementët e sistemit të shuarjes së lëkundjeve (amortizimit) mund të mbingarkohen, por jo më shumë se 20% vlerës së lejuar		Gabim
2166	Lëngu i amortizatorëve hidraulikë duhet të shtohet nga drejtuesi afërsisht çdo tre mijë kilometra		Gabim
2167	Mosfunksionimi i valvolës së nivelimit të amortizatorëve me ajër shkakton mosfunksionim të motorit		Gabim
2168	Mosfunksionimi i valvolës së nivelimit të amortizatorëve me ajër nuk lejon që presioni i brendshëm të ndryshojë sipas ngarkesës		Saktë
2169	Në përgjithësi amortizatorët janë të tipit hidraulik ose me gaz		Saktë
2170	Mosefikasiteti i amortizatorëve zgjat distancën e frenimit		Saktë
2171	Efikasiteti i amortizatorëve përmirëson sigurinë e automjetit gjatë lëvizjes		Saktë
2172	Efikasiteti i elementëve sistemit të shuarjes së lëkundjeve (amortizimit) të automjetit ndikon në komoditetin e pasagjerit		Saktë
2173	Sistemi i amortizimit me ajër i lejon drejtuesit të ndryshojë lartësinë e shasisë së automjetit nga toka		Saktë
2174	Parregullsitë e amortizatorëve rritin rrezikun e verbimit për drejtuesit që vijnë nga drejtimi i kundërt për shkak të lëkundjes së rrezes së dritës nga fenerët		Saktë
2175	Mosefikasiteti i amortizatorëve rrit rrezikun e aquaplaning (mos kapjes)		Saktë
2176	Mosefikasiteti i amortizatorëve rrit rrezikun e rrëshqitjes së mjetit gjatë kthesës		Saktë
2177	Mosefikasiteti i amortizatorëve rrisin lodhjen e shoferit gjatë drejtimit		Saktë
2178	Mosefikasiteti i amortizatorëve përkeqëson dukshmërinë gjatë natës për shkak të lëkundjes së tepërt të rrezes së dritës së fenerëve		Saktë
2179	Mosefikasiteti i amortizatorëve e bën drejtimin e një mjeti të sigurt		Gabim
2180	Amortizatorët e automjeteve shërbejnë për të shuar zhurmën e prodhuar nga djegia e karburantit		Gabim
2181	Sistemi i amortizimit me ajër lejojnë një korigjim të lehtë të qëndrimit falë valvulave speciale të nivelimit		Saktë
2182	Sistemi i amortizimit me ajër nuk mund të komandohet manualisht		Gabim
2183	Sistemi i amortizimit me ajër nuk mund të përdoret në automjetet e artikular		Gabim
2184	Sistemi i amortizimit me ajër nuk mund të përdoret në automjete me peshë bruto të mjetit që tejkalon 3.5 ton		Gabim
2185	Presioni i amortizatorëve duhet të kontrollohet periodikisht		Gabim
2186	Parregullsitë në elementët e sistemit të drejtimit mund të varen mund të varen nga kufizuesi i shpejtësisë që nuk është kalibruar saktë		Gabim
2187	Parregullsitë në elementët e sistemit të drejtimit mund të varen nga bashkimi i gabuar i ingranazheve të kutisë së drejtimit		Saktë
2188	Parregullsitë në elementët e sistemit të drejtimit mund të varen nga humbja e lubrifikantit në kutinë e drejtimit		Saktë
2189	Parregullsitë në elementët e sistemit të drejtimit mund të varen nga gomat e dimrit të montuara gjatë sezonit të nxehtë të verës		Gabim

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
2190	Sistemi i drejtimit shërben për të realizuar lëvizjen e automjetit sipas një trajektore të caktuar dhe për të kryer manovrat e kthimit të mjetit		Saktë
2191	Sistemi i drejtimit ka në përbërje të tij paralelin dhe koka sferike		Saktë
2192	Sistemi i drejtimit mund të jetë me përforcues hidraulik ose me ajër (pneumatik)		Saktë
2193	Sistemi i drejtimit është vetëm i llojit mekanik		Gabim
2194	Sistemi i drejtimit ka në përbërje të tij vetëm grupin e timonit		Gabim
2195	Sistemi i drejtimit nuk ndikon në sigurinë gjatë lëvizjes me mjet		Gabim
2196	Sistemi i drejtimit komandon zakonisht rrotat e para të automjetit		Saktë
2197	Sistemi i drejtimit mund të ketë grupin e timonit të tipit me burmë pa fund dhe rrotë shoqe		Saktë
2198	Sistemi i drejtimit është një nga sistemet kryesore të mjetit që ndikon në sigurinë rrugore		Saktë
2199	Sistemi i drejtimit ka raste që mund të komandojë rrotat e pasme të mjetit		Saktë
2200	Sistemi i drejtimit në të gjithë automjetet është vetëm i tipit me ingranazh dhe kremalierë		Gabim
2201	Sistemi i drejtimit komandon rrotat e para dhe rrotat e pasme të mjetit njëkohësisht		Gabim
2202	Sistemi i drejtimit nuk ka lidhje me sigurinë, gjatë lëvizjes me mjet		Gabim
2203	Grushtet e kthimit, çernierat kardanike ose spinotat e muzove janë pjesë e sistemit të drejtimit të automjetit		Saktë
2204	Në sistemin e drejtimit të automjetit duhet të kontrollohen shpesh kokat e paralelit		Saktë
2205	Në sistemin e drejtimit të automjetit duhet të kontrollohet këndi i rrotullimit bosh të timonit		Saktë
2206	Stabilizatori bën pjesë në sistemin e drejtimit të automjetit		Gabim
2207	Amortizatorët e rrotave të para të automjetit, bëjnë pjesë në sistemin e drejtimit të tij		Gabim
2208	Grupi i timonit është pjesë përbërëse e sistemit të drejtimit të automjetit		Saktë
2209	Grupi i timonit fiksohet në shasinë e automjetit		Saktë
2210	Elementët e grupit të timonit punojnë në ambient vaj		Saktë
2211	Grupi i timonit montohet në urën e parë		Gabim
2212	Grupi i timonit lubrifikohet me vajin e motorit		Gabim
2213	Pas ndërrimit të një elementi të sistemit të drejtimit duhet të kontrollohet konvergjenca e rrotave drejtuese		Saktë
2214	Pas çdo udhëtimi duhet të kryhet konvergjenca e rrotave drejtuese		Gabim
2215	Konvergjenca e rrotave drejtuese nuk influencon (ndikon) në drejtimin e mjetit		Gabim
2216	Përforcuesi në sistemin e drejtimit shërben për të lehtësuar manovrimin e automjetit në lëvizje		Saktë
2217	Përforcuesi në sistemin e drejtimit mund të jenë hidraulik ose me ajër (pneumatik)		Saktë
2218	Përforcuesi në sistemin e drejtimit krijon mundësinë për të lehtësuar forcën që drejtuesi i mjetit ushtron në timon		Saktë
2219	Përforcuesi në sistemin e drejtimit përdoren vetëm në kamionë dhe autobusë		Gabim
2220	Përforcuesi në sistemin e drejtimit shërben për të zvogëluar forcën që ushrohet në kokat sferike		Gabim
2221	Përforcuesi i sistemit të drejtimit nuk përdoret në autovetura		Gabim
2222	Sistemi i drejtimit me përforcues hidraulik ka në përbërje shpërndarësin (servomekanizmin), pompën dhe depozitën e vajit		Saktë
2223	Sistemi i drejtimit me përforcues hidraulik punon me vaj hidraulik që është vetëm për grupin e timonit		Saktë
2224	Drejtuesi i mjetit duhet të kontrollojë nivelin e vajit në depozitë në sistemin e drejtimit me përforcues hidraulik		Saktë
2225	Sistemi i drejtimit me përforcues hidraulik përdoret vetëm në kamionë		Gabim
2226	Sistemi i drejtimit me përforcues hidraulik punon i shkëputur nga grupi mekanik i timonit		Gabim
2227	Sistemi i drejtimit me përforcues hidraulik përdoret vetëm në autovetura		Gabim
2228	Përforcuesi i tipit elektrik në sistemin e drejtimit merr fuqinë nga motori		Gabim
2229	Përforcuesi i tipit hidraulik në sistemin e drejtimit merr fuqinë nga motori		Saktë
2230	Përforcuesi i tipit elektrik në sistemin e drejtimit rrit forcën e ushtruar në timon kur mjeti është në lëvizje		Gabim
2231	Përforcuesi i tipit elektrik në sistemin e drejtimit zvogëlon forcën e ushtruar në timon gjatë kthesave		Saktë
2232	Përforcuesi i tipit elektrik, kur përdoret në tatëpjeta të gjata, mund të mbinxehë gomat		Gabim
2233	Në përgjithësi gomat e pasme të shfryra rrisin performancën e sistemit të drejtimit		Gabim
	TEMA XIV. FRENIMI DHE PËRSHPEJTIMI. NJOHURI MBI LLOJET, NDËRTIMIN, PJESËT KRYESORE. MIRËMBAJTJA E PËRDITSHME E SISTEMEVE. RREGULLATORI I SHPEJTËSISË (BLLOKAZHI), DHE FUNKSIONIMI I SISTEMIT KUNDËR BLLOKIMIT FRENAVE (ABS);		

PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE C1 DHE C KUR MERREN NGA KATEGORIA B

Nr.	Përmbajtja	Fig.	Përgjigja
2234	Sistemi i frenimit transformon në nxehtësi energjinë kinetike që zotëron një automjet në lëvizje		Saktë
2235	Frenat e emergjencës të një automjeti kanë për detyrë të garantojnë një ndalesë emergjente në rast të dështimit të sistemit të shërbimit		Saktë
2236	Sistemi i frenimit të një automjeti të rëndë mund të jetë i tipit pneumatik ose hidropneumatik		Saktë
2237	Koha e transmetimit të forcës frenuese në sistemin e frenimit pneumatik është më e ngadaltë sesa tek sistemet hidraulike të frenimit		Saktë
2238	Në të gjithë kamionët është i detyrueshëm prania e një levë për frenim emergjence që aktivizohet nga pasagjerët kur ata janë të pranishëm		Gabim
2239	Automjetet duhet të jenë të pajisura me 3 sisteme frenimi: shërbimi, emergjence dhe parkimi		Saktë
